



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Teknologji Informacioni”

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Elson Agastra

Dr. Eris Zeqo

Korrik / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Teknologji Informatikë”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Teknologji Informatikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 516, datë 30.06.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr.133, datë 03.04.2015
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS)	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	- 2020-2021; 13 studentë; - 2021-2022; 19 studentë; - 2022-2023; 22 studentë
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

2 / 108

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, është një institucion publik i arsimit të lartë, i licencuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 08.I.1971 me statusin si “Institut Pedagogjik” dhe me Vendimin Nr. 124, datë 01.04.1989, i është vendosur emri “Eqrem Çabej”.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, me njësitë kryesore të tij është akredituar institucionalisht në 16.12.2021 me vendimin nr. 55, të Bordit të Akreditimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me kohëzgjatje prej 4 (katër) vite akademike, deri më 15.12.2025. Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë përbëhet nga tre njësi kryesore, dhe secili prej tyre ka në përbërje njësitë bazë, të organizuara si më poshtë:

1. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

- i. Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë
- ii. Departamenti i Gjuhëve të Huaja
- iii. Departamenti i Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek
- iv. Departamenti i Gjuhës shqipe
- v. Departamenti i Letërsisë Shqipe
- vi. Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies

2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës

- i. Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës
- ii. Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit
- iii. Departamenti i Infermierisë

3. Fakulteti Ekonomik

- i. Departamenti i Kontabilitet - Financës
- ii. Departamenti i Administrimit Publik
- iii. Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit

Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Ky program studimi është hapur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 516, datë 30.06.2010 për “Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë”.

Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë “Dërgim i formularëve të aplikimit për akreditim të programeve të studimit në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë”, drejtuar ASCAL-it, më datë 15.12.2022, Nr. 1685 Prot. dhe protokolluar në ASCAL me Nr. 421 Prot, datë 19.12.2022. Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike ku në përfundim të tij përftohet Diplomë Universitare Bachelor në “Teknologji Informacioni”.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni”. Bazuar në Urdhër nr. Nr.119, Datë 28.09.2023, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, grupi i vlerësimit për këtë program studimi përbëhet nga:

- Prof. Dr. Elson Agastra
- Dr. Eris Zeqo.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Tetor 2023 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacioni i paraqitur edhe në sistemin AMS të ASCAL.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 20 dhe 21 Nëntor 2023, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si mjediset e studimit, bibliotekën, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 18.07.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.85/33 Prot, datë 18.07.2024. Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”,njofton në ASCAL më datë 22.07.2024, me anë të shkresës me Nr. 36 Prot, datë 22.07.2024 “Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknologji Informacioni”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësishë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribuon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 Evid. I.18 Vendimi i hapjes së ILP-së Evid. I.19 Vendimi mbi krijimin e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe hapjen e njësishë kryesore FSHN
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për formimin e studentëve. Në bazë të programit mësimor të hartuar nga institucioni vërehet mbulimi i njohurive bazë si ato të përgjithshme ashtu dhe ato teknike dhe përmbyllen me njohuri specifike në fushën e teknologjisë së informacionit. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit. Evid. I.20 Vendim i hapjes së Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik Evid. II.17 Misioni i Programit të Studimi Bachelor në Teknologji Informacioni
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

6 / 108

Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrër Evid. I.6 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.10 Riorganizimi i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës																					
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që Universiteti i Gjirokastrës ka burimet, kapacitetet dhe përvijën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni". Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, i cili ka në përbërje tre njësi bazë: – Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës; – Departamenti i Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit; – Departamenti i Infermierisë; Burimet njerëzore: Staf akademik bazuar në CV-të rezultoi me përvijë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të Teknologjisë së Informacionit. Nga të dhënat që jepen në DVV, rezultoi numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvijë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të këtij programi studimi. Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) i angazhuar në këtë program studimi, në vitin akademik 2022-2023 kanë kualifikimet si më poshtë: <table><tr><th>Kualifikimi</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>0</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>3</td><td>0</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>4</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Total</td><td>10</td><td>4</td></tr></table> Në Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, i cili është përgjegjës për programin e studimit, (10 staf akademik efektiv dhe 8 staf akademik me kontratë), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë: <table><tr><th>Kualifikimi</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr></table>	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	0	1	Prof. Asoc.	3	0	Dr./PhD	4	1	Msc.	3	2	Total	10	4	Kualifikimi	PAE	PAK
Kualifikimi	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	0	1																				
Prof. Asoc.	3	0																				
Dr./PhD	4	1																				
Msc.	3	2																				
Total	10	4																				
Kualifikimi	PAE	PAK																				

	Prof. Dr.	0	1
	Prof. Asoc.	3	0
	Doc. Dr.	3	0
	Dr./PhD	2	1
	Dr. në proces	0	0
	Msc	2	6
	Total	10	8
	Stafi akademik ka kualifikimin e duhur për formimin e njësive bazë si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. Evid. III.4 CV-të e Personelit Akademik dhe ndihmës akademik Evid. I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 Evid. I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 19-20, 20-21, 21-22 Evid. I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 19-20, 20-21, 21-22 Evid. I.14 Organograma e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.15 Organograma e Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.16 Organograma e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës		
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni" (shih RVB) është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si dhe atë të njësive bazë, të Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës. Evid. I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.10 Riorganizimi i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës		

Konkluzione	<i>Programi i studimit, Bachelor në "Teknologji Informacioni" ofrohet në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.</i> <i>Programi i studimit bazohet ofrohet nga njësi bazë dhe kryesore që zhvillojnë aktivitetin e tyre akademik dhe shkencor në fusha që përfshijë edhe atë të këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ lidhur me vlerësimin e këtij kriteri mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, statutin dhe rregulloren e institucionit, si dhe aktet rregullatore specifike, po ashtu dhe përgjigjet e grupeve gjatë takimeve të organizuara në institucion dhe konstaton se Universiteti i Gjirokastrës siguron më së miri marrëdhëniet brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të tij ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukturës. Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren e tij. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Informacioni" i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (Njësia e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokolli, Zyra e burimeve njerëzore, etj.) si dhe departamentet e tjera në Fakulteti e Shkencave të Natyrës dhe në tërësi brenda institucionit. Kjo duket edhe në mësimdhënie, ku disa prej lëndëve të këtij programi studimi mbulohen nga staf akademik i njësive të tjera bazë të këtij fakulteti dhe në përgjithësi të këtij universiteti, sipas fushës së tyre të ekspertizës.

	Evid. I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 19-20, 20-21, 21-22 Evid. I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 19-20, 20-21, 21-22 Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2021-2022 Evid. III.4 CV-të e Personelit Akademik dhe ndihmës akademik Evid. VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022 Evid. VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni ka vendosur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me aktor lokal, kryesisht në rajonin e Gjirokastrës dhe institucione lokale. Në kuadër të përfshirjes së institucionit dhe stafit akademik, janë realizuar edhe një sërë projektsh kërkimore dhe për transferimin e njohurive, me partner kombëtar dhe ndërkombëtar. Marrëveshje të cilat i kanë lejuar institucionit të përmirësojë kapacitetet laboratorike dhe mësimdhënëse. Në këtë kuadër, janë përfshirë edhe në planin mësimor të programeve të studimit master në fushën e mësuesisë, rezultatet e projektit TeComp. Institucioni ka realizuar disa projekte të financuara nga AKKSHI (Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit), apo nga vet UGJ. Në tërësinë e këtyre projekteve, Fakulteti i Shkencave të natyrës është përfshirë në shumë pak krahasuar me fakultetet e tjera. Projektet ku ka qenë i përfshirë janë “Dixhitalizimi i infrastrukturës së mësimdhënies në UGJ, 6 klasa” për periudhën 2022-2023, si dhe projekti “Projekt kërkimor për aplikimin e ICT-së në mësimdhënien e ICT-së” në vitin 2019. Megjithatë nuk vërehet një bashkëpunim me aktor të biznesit apo institucione të lidhura ngushtësisht me objektivat e këtij programi studimi si në nivel lokal, ashtu edhe kombëtar apo ndërkombëtar. <i>GVJ gjykon se institucioni duhet të rrisë përpjekjet për rritjen e bashkëpunimeve me aktor të biznesit në fusha specifike të teknologjisë së informacionit.</i> Evid. II.32 Përfshirja në planet mësimore e materialeve në kuadër të projektit TeComp Evid. II.33 Memorandum IAL dhe MAS për TEAVET Evid. II.34 Projekti TEAVET Evid. II.35 TEAVET-modulet

Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni”, i ofruar nga Universiteti i Gjirokastrës, nuk parashikon në planin mësimor lëndën “Praktikë profesionale”. Si pasojë e kësaj mungese, edhe marrëveshjet e bashkëpunimit nuk përdoren zyrtarisht për zhvillimin e praktikave mësimore. <u>Rekomandohet që institucioni të shtojë në planin mësimor lëndën e “Praktikës profesionale” dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të shfrytëzohen në kuadër të kryerjes së praktikave profesionale, të institucionalizuar dhe ti shërbejnë studentëve të këtij programi studimi me qëllim afrimin e tyre në tregun e punës</u> Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ Evid. I.24 Lista e projekteve të UGJ Evid. III.8 Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ Evid. IV.9 Marrëveshje me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Evid. IV.9.1 Marrëveshje me Drejtorinë e Spitalit Rajonal				
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në fund të vitit akademik, njësia bazë, realizon analizën e punës mësimore dhe shkencore ku përveç aspekteve të tjera të punës që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e këtij programi studimi, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit. Në këto analiza evidentohehen efektet pozitive dhe përfitimet e këtyre marrëveshjeve në tërësi në funksion të realizimit të qëllimeve të këtij programi studimi, por edhe të evidentimit të mangësive të tyre. Megjithatë, vërehet se institucioni ka vështirësi në realizimin e marrëveshjeve të frytshme bashkëpunimi me aktor të biznesit apo tregut të punës specifikisht në fushën e këtij programi studimi. Evid. III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit Evid. III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete Evid. V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantë				
Konkluzione	<i>Universiteti i Gjirokastrës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në tërësi, por ka një numër të ulët marrëveshjesh në fushën apo me objektiv, teknologjinë e informacionit.</i> <u>Rekomandohet që institucioni të shtojë në planin mësimor lëndën e “Praktikës profesionale” si dhe të rrisë bashkëpunimet në fushën e teknologjisë së informacionit.</u>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” përmban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) sipas parashikimeve të VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. Megjithatë, ndarja e lëndëve të këtij programi studimi, në kategori sipas parashikimeve të VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar, nuk ka një përputhje me objektivat formuese të lëndëve të veçanta në kuadër të objektivave formuese të këtij programi studimi. Disa lëndë janë parashikuar si lëndë të “Formimit bazë” kur përmbajtja dhe përvetësimi i tyre kërkon njohuri të lëndëve të përcaktuara në “Formim karakterizues”. Pra në analizën logjike të ndarjes së lëndëve të një programi studimi, nuk mund të jetë lëndë e formimit bazë, një lëndë e cila për tu përvetësuar, ka nevojë lëndët e formimit karakterizues. Kjo, edhe pse një ndarje formale e lëndëve në kategori, është e nevojshme edhe për të përcaktuar në vijim të zhvillimit të këtij programi studimi, se cilat njohuri janë thelbësore dhe karakterizuese në formimin profesional të studentëve.

Sugjerohet institucioni të rishikojë ndarjen e lëndëve në kategori të parashikuara në VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar.

Aktiviteti didaktik për këtë program studimi shtrihet në

- Leksione
- Seminare
- Laboratorë
- Studim Individual

Mesatarisht, programi i studimit kërkon një angazhim të studentit dhe institucionit sipas tabelës në vijim:

Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti
Viti i parë	690	810	46% / 54%
Viti i dytë	630	870	42% / 58%
Viti i tretë	615	885	41% / 59%
Totali	1935	3090	43% / 57%

Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, vërehet se institucioni nuk ka përcaktuar ndarjen në kredite ECTS brenda lëndëve për aktivitetet e nevojshme didaktike si Leksione, Seminare apo laborator dhe projekte/detyra kursi.

Nga kjo vërehet edhe mungesa në mënyrë të detajuar të orëve laboratorike të nevojshme për përvetësimin e disa prej lëndëve karakterizuese të këtij programi. Ku në totalin e 4500 orë mësimnxënies për këtë program, vetëm 90 orë janë parashikuar si aktivitete laboratorike, përkatësisht në lëndën e “Fizikës” (30 orë), në lëndën “Programin Object Oriented” (30 orë) dhe Bazë të Dhënash (30 orë).

Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u vu në dukje, se edhe në lëndë të tjera të këtij programi studimi, zhvillohen aktivitete laboratorike, brenda orëve të parashikuara në auditor, pavarësisht se ato nuk janë të përcaktuara qartazi në planin mësimor. Gjithashtu, duke patur parasysh edhe numrin e ulët të studentëve në këtë program studimi, zhvillimi i aktiviteteve laboratorike është i gërshtuar me ato të ushtrimeve/seminareve. Megjithatë, duke qenë se plani mësimor, është një informacion publik i cili paraqet në formë të përmbledhur kapaciteteve formuese të çdo programi studimi, ai duhet të paraqesë qartazi aftësitë dhe kompetencat që ofron, si për studentët aktual, ashtu edhe për kandidatët për

student në këtë program studimi në vijim. Gjithashtu, plani mësimor së bashku me plan programet lëndore, janë një nga dokumentacionet bazë që shoqërojnë formimin e studentëve, sidomos në rastet e transferimit të krediteve nga ky institucion drejt një institucioni tjetër. Mos paraqitja e plotë apo e qartë e ndarjes së lëndëve në aktivitete formuese, si në kredite ashtu edhe në orë mësimore përkatëse, mund të vështirësojnë njohjen e krediteve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi studimi kur transferohen në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

Përcaktimi i krediteve për çdo aktivitet didaktik ndihmon jo vetëm studentin për të baraspeshuar shpërndarjen e orëve të studimit për lëndë dhe aktivitete të saj, por shërben edhe për stafin akademik mësimdhënës për të vlerësuar edhe peshën që laborator apo detyra/projekti duhet të kenë në vlerësimin përfundimtar. Gjithashtu, një ndarje e aktiviteteve formuese, gjithmonë, brenda lirisë akademike të stafit mësimdhënës, i lejon edhe institucionit të monitorojë dhe të ketë instrumente sasiore vlerësues të stafit në impenjimin e tij me studentët, por edhe të vlerësojë nevojën për infrastrukturë në mbështetje të programit të studimit. Pra përcaktimi i krediteve për aktivitetet laboratorike, dhe orëve përkatëse, i mundësojnë institucionit të vlerësojë në mënyrë sasiore oraret dhe mjaftueshmërinë e ambienteve laboratorike dhe kapacitetet maksimale që ato kanë për tu shfrytëzuar

GVJ rekomandon që, Institucioni të rishikojë hartimin e planit mësimor, duke përcaktuar qartazi të gjitha aktivitetet didaktike formuese (Leksione, seminare/ushtrime, laborator, projekte/detyra kursi, etj) të nevojshme për përvetësimin e njohurive për secilën lëndë.

Nëse i referohemi planit mësimor të paraqitur në tabelat 10 në RVB dhe konkretisht planit mësimor, vërehet që lëndë me 5, 6 apo 7 kredite ECTS, zënë në auditor po 30 orë për leksione, pra ngarkesë të barabartë në auditor, pavarësisht peshës të ndryshme në kredite ECTS, apo nevojës për përcaktimin e orëve laboratorike.

Në tabelën në vijim paraqiten disa lëndë dhe ndarjet në aktivitete didaktike

Lënda	ECTS për lëndë	Orë leksione	Orë Seminare	Orë Laborator	Orë totale në auditor
Arkitekturë dhe Organizim Kompjuteri	6	30	30	0	60
Programim 1	11	75	60	0	135
Hyrje në Sisteme Programimi	6	30	30	0	60
Programim Object Oriented	7	30	30	15	75
Bazë të Dhënash	6	30	0	30	60
Software Engineering	5	30	30	0	60

Sugjerohet që institucioni të mbajë një ndarje uniforme të ngarkesës për kredit në auditor për secilin aktivitet, si p.sh. X orë në auditor/kredit laborator; Y orë në auditor / kredit seminari, etj. Nëse për secilën lëndë specifike, gjykohet se studenti duhet të ketë një formim më të thellë për këtë aktivitet, të rrisë peshën e tij në kredite, çka automatikisht përkthehet në numër orësh në auditor.

Në këtë mënyrë bëhet e mundur vlerësimi cilësor dhe sasior i ngarkesës si për stafin akademik, por edhe për studentët për përfitimin e njohurive përkatëse. Gjithashtu, ndarje e kësaj ngarkese mundëson vlerësimin sasior të mjaftueshmërisë së aktiviteteve të parashikuara për secilën lëndë dhe aktivitet didaktik.

5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse
 Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022
 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23
 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22
 Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit bachelor në “Teknologji Informacioni”, mund të vecojmë synimet dhe objektivat e caktuara nga institucioni për këtë program studimi: – Ky program ka për qëllim të përgatisë specialisët të aftë të përdorin sistemet hardware dhe software në një nivel të lartë profesional. Ata të jenë të aftë të veprojnë si dizenjues, programues dhe rregullues të sistemeve kompjuterike, sistemeve digjitale, rrjeteve kompjuterike, sistemeve bazë kompjuterike dhe programues, dhe administrator të sistemeve të bazave të të dhënave dhe sistemeve të informacionit. – Programi synon të sigurojë një infrastrukturë nëpërmjet së cilës studentët mund të fitojnë njohuri teknike, analitike dhe menaxheriale dhe aftësi ndërpersonale dhe zhvillojnë shprehje, mundësi dhe aftësi të rëndësishme për pjesëmarrjen efektive dhe qënien lider në prodhim. – Ky program studimi 3-vjeçar do të përgatis të diplomuarit për të hyrë si një fuqi aktive në industrinë kompjuterike si praktikien rishtar për të zhvilluar software apo për të aplikuar teknologjinë kompjuterike në organizmat shoqërore. – Të diplomuarit do të arrijnë njohuritë teknologjike themelore të sistemeve kompjuterike, gjuhëve të programimit, aplikimeve kompjuterike dhe sistemeve të informacionit. Evid. II.17 Misioni i Programit të Studimi Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23			
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” përmban shpërndarjen e 180 krediteve ECTS midis lëndëve ndarjen në pesë kategori (A, B, C, D, E) sipas parashikimeve të VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. <table><tr><td>Tipi i komponentit mësimor</td><td>Ndarja nga UGJ</td><td>Norma sipas VKM 41</td></tr></table>	Tipi i komponentit mësimor	Ndarja nga UGJ	Norma sipas VKM 41
Tipi i komponentit mësimor	Ndarja nga UGJ	Norma sipas VKM 41		

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

16 / 108




ngarkesën përkatëse në kredite.

<i>Lëndë Bazë (A)</i>	<i>34 ECTS - 18.9%</i>	<i>15% - 20%</i>
<i>Lëndë Karakterizuese (B)</i>	<i>95 ECTS - 52.8%</i>	<i>50% - 55%</i>
<i>Lëndë Ndërdisciplinore/ Integruese (C)</i>	<i>25 ECTS - 13.9%</i>	<i>12% - 15%</i>
<i>Lëndë Plotësuese (D)</i>	<i>18 ECTS - 10%</i>	<i>10% - 15%</i>
<i>Detyrime Përmbyllëse (E)</i>	<i>8 ECTS - 4.4%</i>	<i>3% - 5%</i>

Megjithatë, ndarja e lëndëve të këtij programi studimi, në kategori sipas parashikimeve të VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar, nuk ka një përputhje me objektivat formuese të lëndëve të veçanta në kuadër të objektivave formuese të këtij programi studimi. Disa lëndë janë parashikuar si lëndë të "Formimit bazë" kur përmbajtja dhe përvetësimi i tyre kërkon njohuri të lëndëve të përcaktuara në "Formim karakterizues". Pra në analizën logjike të ndarjes së lëndëve të një programi studimi, nuk mund të jetë lëndë e formimit bazë, një lëndë e cila për tu përvetësuar, ka nevojë lëndët e formimit karakterizues.

Kjo, edhe pse një ndarje formale e lëndëve në kategori, është e nevojshme edhe për të përcaktuar në vijim të zhvillimit të këtij programi studimi, se cilat njohuri janë thelbësore dhe karakterizuese në formimin profesional të studentëve.

Sugjerohet institucioni të rishikojë ndarjen e lëndëve në kategori të parashikuara në VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar.

Bazuar në planin mësimor por edhe në plan programet e lëndëve, vërehet se secila lëndë ka të përcaktuar objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët në total kreditesh, por pa i ndarë ato në aktivitete didaktike formuese si Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj. Një ndarje midis orëve në auditor për Leksione dhe për seminare paraqitet edhe për ato lëndë që për karakteristikat e tyre kanë të nevojshme zhvillimin e orëve laboratorike.

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik i cili u pyet rreth këtij argumenti, u sqarua se pavarësisht se në plan-programet e lëndëve, nuk është parashikuar në zë të veçantë aktiviteti laboratorik, zhvillimi i

	tyre është i integruar ku për lëndë karakterizuese zhvillohet në laboratorët e informatikës. Kjo bën të mundur që ushtrimet e parashikuara për lëndën, përveç trajtimit teorik të mirëfilltë, zhvillohen si zgjidhje kompjuterike nga studentët gjatë këtyre seancave ushtrimore. <i><u>Rekomandojmë</u> institucionin të plotësojë syllabuset dhe planin mësimor në përputhje me VKM 41 e ndryshuar duke saktësuar kreditet dhe orët mësimore për secilin aktivitet didaktik (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj.).</i> 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Plani mësimor parashikon në total 25 lëndë mësimore si dhe “Provimi i përgjithshëm Përfundimtar/Punim Diplome” për një total prej 26 lëndë/module didaktike. <i>Ky program studimi nuk ka të parashikuar lëndën e “Praktikës Profesionale”.</i> “Provimi i përgjithshëm Përfundimtar/Punim Diplome” është parashikuar si detyrime përmbyllëse me 8 kredite ECTS në kategorinë “E”. Duke përbërë 4.4 % të peshës totale të programit. Megjithatë, referuar VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar, por edhe programeve të tjera të ngjashme të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë, sugjerohet të shtohet edhe lënda e “Praktikës Profesionale” e cila të zhvillohet pranë kompanive apo institucioneve publike me të cilat institucioni ka apo do të nënshkruaj marrëveshje bashkëpunimi. <i><u>Sugjerojmë</u> institucionin, që të shtojë në planin mësimor lëndën e praktikës profesionale duke e shoqëruar edhe me syllabusin përkatës, ku të përshkruhen së paku detyrimet e studentit për objektivat, zhvillimin dhe vlerësimin e këtij aktiviteti formues.</i> 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status	Nuk aplikohet

të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.

Referuar dokumentacionit shoqërues të këtij raporti, të vëna në dispozicion nga Universiteti i Gjirokastrës dhe duke i krahasuar ato me programe të ngjashme studimit të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, ku më poshtë përmendim disa prej tyre si:

- Universiteti i Tiranës
 - o Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"
- Universiteti "Fam S. Noli", Korçë
 - o Bachelor në "Teknologji Informacioni"
- Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
 - o Bachelor në "Teknologji Informacioni"
- Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
 - o Bachelor ne Teknologjite e Informacionit
- Universiteti European i Tiranës
 - o Bachelor në "Teknologji Informacioni"

Vihet re se plani mësimor në emërtime lëndësh është i përafërt me programet ngjashme të ofruara nga IAL të tjera brenda vendit dhe në përputhje me objektivat e formimit të këtij programi studimi. Por ndryshe nga IAL-të e tjera, në Universitetin e Gjirokastrës, programi i studimit nuk ka të parashikuar lëndën e "Praktikës profesionale" sikurse u vu në dukje edhe në kriteret më sipër.

IAL	Orë në auditor	Orë studim individual	Totali	Raport për qindje
Universiteti i Tiranës	1945	2555	4500	43 % / 57 %
Universiteti i Elbasanit	2165	2335	4500	48 % / 52 %

Universiteti i Vlorës	1770	2730	4500	39 % / 61 %
Universiteti i Korçës	2143	2357	4500	48 % / 52 %
Universiteti Europian i Tiranës	1832	2668	4500	41 % / 59 %
Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastrë	1935	3090	4500	43 % / 57 %

Të dhënat për planet mësimore të institucioneve të përmendur në tabelën më sipër i referohen raporteve për program studimi që janë të publikuar në faqen zyrtare të ASCAL, informacione për planet mësimore të publikuara në faqet ueb online të vet IAL-vë.

Nga analiza e lëndëve, syllabuseve dhe shpërndarjes së tyre gjatë viteve akademike, vërehet si programi i studimit bachelor në "Teknologji Informacioni", i ofruar në Universitetin e Gjirokastrës, ka ngjashmëri me programe ekuivalente të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Megjithatë, vërehet që disa lëndë kanë përmbajtje jo plotësisht të koordinuar brenda këtij programi. Këtu përmendim lëndët si më poshtë:

- "Programim 1" e cila zhvillon argumente në C++ (të orientuara nga objektet).
- "Hyrje në sisteme Programimi" zhvillon njohuri në gjuhën C.
- "Programim Object Oriented" zhvillon njohuritë në C#.
- "Strukturë të dhënash" zhvillon argumentet në C.
- "Programim 2" zhvillon argumentet në C#
- "Gjuha Assembly" (lëndë me zgjedhje), edhe pse në profilin e këtij programi studimi, nuk gjendet e trajtuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë në programe të ngjashme.

Lëndë që trajtojnë argumenta të ngjashëm, por duke përdorur gjuhë të ndryshme programimi, dhe disa prej tyre zhvillohen paralelisht në të njëjtin semestër, në vitin e parë. Kjo mund të

	jetë burim paqartësia dhe ngatërrimi sidomos për studentët e vitit të parë. Gjithashtu, lënda “Programim 2”, në vitin e dytë, në argumentet që trajton, është edhe ndërveprimi me bazat e të dhënave. Por studenti njohuritë e bazave të të dhënave studenti i fiton në vitin e tretë. <i>Sugjerojmë institucionin të koordinojë lëndët dhe përmbajtjen e tyre në harmoni me objektivat formuese të programit të studimit duke maksimizuar edhe rendimentin e përcimit të njohurive në shkallë graduale rritëse tek studentët.</i> 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ https://sites.google.com/a/fshn.edu.al/depinfo/studime-te-nivelit-te-pare/teknologji-informacion https://www.ascal.al/media/documents/rvj/PS_973_1139.pdf https://www.ascal.al/media/documents/rvj/PS_1737_982.pdf https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Bachelor-n%C3%AB-TEKNOLOGJI-INFORMACIONI.pdf https://uniel.ems.al/school/program/dd0c20d2-944a-4dd0-bb36-a6fd0141e3ec.aspx
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Për sa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentacionit shoqërues si dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi është përcaktuar nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, me kodin: 63BA0610S dhe përcjellë në ministrinë përgjegjëse për arsimin më datë 16.03.2023 me shkresë zyrtare Nr. 343 Prot. i Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë. Evid. I.22 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve Evid. I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FSHN
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas	Nuk aplikohet

dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Lëndët dhe formimi në tërësi i programi të studimit, është në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimi dhe i ngjashëm me ato të ofruara nga IAL të tjera.</i> <i>Në planin mësimor nuk janë të saktësuara kreditet dhe orët në auditor për aktivitetet didaktike (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj.) që parashikon çdo lëndë sipas VKM 41 e ndryshuar. <u>Institucioni</u> duhet të plotësojë planin mësimor dhe syllabuset duke saktësuar aktivitetet didaktike (Leksione, Seminare, Laborator, Projekte kursi, etj.) për secilën lëndë si dhe orët në auditor në përpjestim të drejtë me kreditet që secili aktivitet zë në tërësinë e lëndës dhe të planit mësimor.</i> <i>Institucioni të hartojë një ndarje të orëve në auditor për secilën lëndë, në përpjestim me kreditet që ajo zë në planin mësimor, duke mbajtur si njësi etalon, kreditin ECTS.</i> <i>Institucioni të riorganizojë ndarjen e lëndëve në kategori sikurse kërkohet nga VKM 41 e ndryshuar, duke ndjekur edhe një rrjedhë logjike të lëndëve të formimit bazë, karakterizues, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse.</i> <i>Institucioni të riorganizojë planin mësimor, shpërndarjen e lëndëve në semestër si dhe argumentet dhe njohuritë e trajtuara në secilën lëndë. Kjo për të rritur efikasitetin e përçimit të njohurive dhe studenti për të përvetësuar argumentat e një lëndë, të bazohet në njohuritë e fituara në lëndët e më parshme.</i> <i>Ky program studimi nuk parashikon lëndën e "Praktikës profesionale" që gjykojmë se është e nevojshme për një program të tillë studimit. <u>Sugjerojmë</u> institucionin, që të shtojë në planin mësimor lëndën e praktikës profesionale duke e shoqëruar edhe me syllabusin përkatës, ku të përshkruhen së paku detyrimet e studentit për zhvillimin dhe vlerësimin e këtij aktiviteti formues.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.55, datë 16.12.2021 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 4 vite, për periudhën nga 16/12/2021 deri në 15/12/2025. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 njësi bazë: 1. Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës; 2. Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit; 3. Departamenti i Infermierisë; Duke përmbushur kështu edhe kriteret ligjore për qëndrueshmërinë e njësisë kryesore. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, për vitin akademik 2022-2023, ka në përbërjen e tij, 29 personel akademik efektiv(PAE) i ndarë në tre njësi bazë, si: <table><tr><th>Njësia bazë</th><th>Nr. PAE</th><th>Tituj/Grada</th></tr><tr><td>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës</td><td>10</td><td>0 – Prof. Dr. 3 – Prof. Asoc. 5 – Dr. / Docent. 0 – Dr. në Proc. 2 - Msc</td></tr><tr><td>Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit</td><td>8</td><td>1 – Prof. Dr. 4 – Prof. Asoc. 3 – Dr. 0 – Dr. në Proc. 0 - Msc</td></tr><tr><td>Departamenti i Infermierisë</td><td>11</td><td>0 – Prof. Dr. 2 – Prof. Asoc. 4 – Dr. / Docent. 0 – Dr. në Proc. 5 - Msc</td></tr><tr><td>Total</td><td>29</td><td>29</td></tr></table> Secila njësi bazë, përfshirë edhe Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, përmbush kriteret minimale të parashikuara në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin	Njësia bazë	Nr. PAE	Tituj/Grada	Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	10	0 – Prof. Dr. 3 – Prof. Asoc. 5 – Dr. / Docent. 0 – Dr. në Proc. 2 - Msc	Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit	8	1 – Prof. Dr. 4 – Prof. Asoc. 3 – Dr. 0 – Dr. në Proc. 0 - Msc	Departamenti i Infermierisë	11	0 – Prof. Dr. 2 – Prof. Asoc. 4 – Dr. / Docent. 0 – Dr. në Proc. 5 - Msc	Total	29	29
Njësia bazë	Nr. PAE	Tituj/Grada														
Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	10	0 – Prof. Dr. 3 – Prof. Asoc. 5 – Dr. / Docent. 0 – Dr. në Proc. 2 - Msc														
Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit	8	1 – Prof. Dr. 4 – Prof. Asoc. 3 – Dr. 0 – Dr. në Proc. 0 - Msc														
Departamenti i Infermierisë	11	0 – Prof. Dr. 2 – Prof. Asoc. 4 – Dr. / Docent. 0 – Dr. në Proc. 5 - Msc														
Total	29	29														

minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësive bazë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e Departamentit, që ofron programin Bachelor në “Teknologji Informacioni” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të DMIF	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	1	-	1	-	1
Prof. Asoc.	2	-	3	0	3	-
Dr/Phd	7	-	5	1	5	1
Msc.	4	6	3	5	2	6
Total	13	7	11	7	10	8

Formimi i stafit akademik i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, është në përputhje me objektivat e kësaj njësie bazë duke qenë 3 me formim informatikë/teknologji informacioni, 1 me formim fizike, 6 me formim matematikë.

Bazuar edhe në tabelat e hartuara nga institucioni, por edhe nga planet mësimore, vërehet se në pjesën më të madhe të lëndëve, titullarët janë me grada dhe tituj në përputhje me pikën 6 të nenit 59 të ligjit 80/2015. Por një pjesë e titullarëve dhe lektorëve të lëndëve, sidomos ato të formimit karakterizues, janë vetëm me kualifikimin “Master i Shkencave”.

Sugjerohet institucioni të përfshijë për secilën lëndë, titullar dhe lektor, staf akademik me kualifikimin së paku me gradën shkencore “Doktor” dhe si asistent lektor, edhe staf me kualifikimin “Master i Shkencave”.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore (ref. Tabelave 12), u konstatua se për tre vitet akademike mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, PAE. Konkretisht:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2020-2021	1935	1770	165	91% / 9 %
2021-2022	1915	1540	375	80% / 20%

	2022-2023	1935	1515	420	78% / 22%
	Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës përmbushet plotësisht. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.14 Organograma e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.15 Organograma e Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.16 Organograma e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës Evid. I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik Evid. I.21.1 Plani i veprimit për Akreditimin Institucional periodik Evid. I.21.2 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e planit të veprimit Evid. III.4 CV-të e Personelit Akademik dhe ndihmës akademik				
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës angazhon në ndihmë të procesit akademik, në total 5 personel ndihmës akademik të ndarë në njësitë bazë si vijon: - 1 personel në Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës; - 2 personel në Departamentin e Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit; - 2 personel në Departamentin e Infermierisë; Duke përmbushur kështu edhe detyrimet ligjore në angazhimin e stafit ndihmës akademik. Evid. I.29 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik DMIF për vitin akademik 20-21, 21-22, 22-23 Evid. III.2 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DMIF Evid. III.3 Inventari i mjeteve laboratorike në DMIF Evid. III.4 CV-të e Personelit Akademik dhe ndihmës akademik Evid. IV.7 Detyrat dhe ngarkesa e personelit ndihmës akademik				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e	Njësia bazë, Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, përgjegjës për këtë program studimi, duke patur në konsideratë numrin e ulët të studentëve në të tre vitet e këtij programi, nuk ka përcaktuar një person në rolin e koordinorit				

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

25 / 108

koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	të programit. Kërkesat dhe kompetencat e koordinatorit të programit, në këtë rast, plotësohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Drejtues që në këtë proces ndihmohet edhe nga drejtuesit e grupeve mësimore – kërkimore. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, në tërësi, dhe Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.</i> <i>Në disa lëndë, kryesisht karakterizuese, stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie, nuk ka kualifikimet e duhura në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</i> <i>Institucioni duhet të gjejë mekanizma të përfshijë staf të kualifikuar me tituj dhe grada, apo/edhe të ndihmojë në rritjen e kualifikimit të stafit ekzistues.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në Teknologji Informacioni, Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor. Të dhëna që janë edhe në nivel të njësisë kryesore. Megjithatë, sikurse u përmend në Standardin II.1 më sipër, institucioni nuk i ka të detajuar në formë të plotë planin mësimor në përputhje me VKM 41 të ndryshuar.

	Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.4.1 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e Rregullores së Studimeve në UGJ Evid. I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.5.1 Vendimi i FSHN për miratimin e rregullores Evid. I.6 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informatike
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informatike është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 25 lëndë të ndara sipas 3 viteve: – 8 lëndë në vitin e parë; – 9 lëndë në vitin e dytë; – 8 lëndë + provimi i diplomës në vitin e tretë; Në vitin e tretë është parashikuar edhe punimi i diplomës ose provimi i formimit me 8 kredite ECTS. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi. Megjithatë, kjo ndarje, edhe pse plotëson raportet mes kategorive, mund të përmirësohet në kuadër edhe të gjetjeve dhe sugjerimeve të paraqitura në Standardin II.1, kriteri 3. <i>Institucioni të rishikojnë ndarjen e lëndëve në kategori sipas VKM 41 e ndryshuar, dhe në përputhje me objektivat dhe lëndët karakterizuese të këtij programi studimi.</i> Plani mësimor i këtij programi studimi, i organizuar në 25 lëndë dhe provimin përfundimtar, ka të parashikuar ngarkesën totale në kredite për secilën lëndë, për një total prej 180 kredite ECTS. Kreditet e secilës lëndë nuk janë më tej të ndara në aktivitete formuese si Leksione, Seminare/Ushtime, Laboratore, Projekte/Detyra kursi, praktika etj. Edhe ndarja e orëve mësimore në auditor, nuk është e përcaktuar në një përpjesëtim të drejtë me kreditet e lëndës apo të aktiviteteve formuese. Sikurse u përmend edhe në Standardin II. Në këtë mënyrë nuk është e mundur të kuptohet pesha e secilit aktivitet në formimin e studentëve dhe gjithashtu nuk mundëson realizimin e një analize mbi mjaftueshmërinë e ambienteve laboratorike.

	5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22 Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21 Evid. II.29 Struktura Mësimore Bachelor në Teknologji Informacioni
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Institucioni, dhe në veçanti, Njësia Bazë e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, propozon vit për vit kriteret specifike të pranimit bazuar në cilësinë dhe programet e maturantëve dhe nevojat e tregut për profilin Bachelor në Teknologji Informacioni. Në rregulloren e njësise kryesore dhe në atë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre. Në këtë kuadër, në rregulloren e programit të studimit, është përcaktuar si kriter për njohjen e krediteve në transferim të studimeve, një ngjashmëri së paku prej 80% të formimit. Ky kriter, është në përputhshmëri me aktet rregullatore në fuqi, por më kufizues, pasi në tërësi, në aktete rregullatore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, ngjashmëria e programeve kërkohet në së paku 70% të njohurive për të ekuivalentuar kreditet dhe vlerësimet përkatëse. Vlerësimi i ngjashmërisë së programeve të studimit apo njohurive specifike të fituara në secilën lëndë, janë vlerësimi i komisionit ad-hoc të ngritur për vlerësimin e kërkesave për transferim. Edhe pse vlerësimi njerëzor i kriterit të ngjashmërisë është i logjikshëm në kuadër të njohurive që kërkohen të transferohen, mbajta e një mase prej 80% si kriter, mund të dekurajojë studentët potencial që dëshirojnë të transferojnë apo njohin studime të mëparshme në IAL të tjera, pranë Universitetit Eqrem Çabej, Gjirokastrë. <i><u>Sugjerimë që kriteri i ekuivalentimit të njohurive, të përcaktohet jo më pak se 70% ngjashmëri në formimin e njohurive.</u></i> Evid. II.20 Procedurë e transferimit të studentëve Evid. 10 Rregullore e Sekretarise mesimore Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë

	Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informatike Evid. V.14 Udhërrëfyshi i studentëve
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informatike, janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës jep informacion mbi pedagogun që do të zhvillojnë modulën/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre, si dhe literaturën përkatëse. Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën totale për studentin në auditor. Paraqitet gjithashtu përshkrimi i lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literatura kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënies të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit dhe metodat e vlerësimit të njohurive. Megjithatë, institucioni në programet e lëndëve nuk ka caktuar qartë ndarjen në kredite të aktiviteteve didaktike formuese, por vetëm ngarkesën që ato paraqesin për studentin në orë studimore në auditor. Nga analiza e detajuar e syllabuseve të lëndëve të këtij programi studim, vihet re se në disa prej tyre është paraqitur pedagogu i lëndës dhe jo titullari i saj, lektor që në disa lëndë ka kualifikimin "Master i Shkencave". Kujtojmë se për zhvillimin e leksioneve në auditor, personeli akademik duhet të jetë i kategorisë "lektor", pra të ketë së paku gradën shkencore "Doktor", ndërsa në zhvillimin e aktiviteteve didaktike si seminare, laborator etj., personeli akademik që angazhohet duhet të ketë së paku formimin e një cikli më të lartë se ai programit të studimit ku angazhohet. Në rastin e këtij programi studimit, duhet të jetë së paku me kualifikimin "Master i Shkencave". Për më shumë, shih Standardin II.1, kriteri 1, më sipër. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22

	Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, vërejmë se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhohet në përditësimin e vazhduar të programit të studimit që ofron. Në veçanti, në fund të vitit akademik, pedagogët e përfshirë në programin e studimit që po analizojmë, hartojnë një relacion përshkrues për të gjitha aspektet e mësimdhënies duke vënë në dukje problematika të hasura dhe sugjeruar zgjidhje për të ardhmen. Gjithashtu, institucioni përdor edhe raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC-ja për përditësimin e programit të studimit. <i>Megjithatë, vërehet se përmbajtja e programeve të lëndëve nuk janë azhornuar në tre vitet e fundit, sipas dokumentacionit të paraqitur. Gjithashtu, edhe organizimi i planit mësimor jo për të gjitha lëndët mundëson përçimin efektiv të njohurive, pasi disa lëndë që ofrojnë njohuri fillestare zhvillohen pas lëndëve që i kanë të nevojshme që studenti ti ketë përvetësuar ato njohuri duke mos garantuar një efikasitet të procesit mësimdhënës.</i> Gjithashtu, në syllabuset e lëndëve, sidomos të atyre karakterizuese, vërehet përdorimi i një literature të vjetëruar dhe jo koherente me objektivat e këtij programi studimi. <u>Sugjerohet</u> institucionin jo vetëm të azhurnojë planet mësimore me literaturë koherente, por edhe të mundësojë kopje të tyre në bibliotekën e institucionit. Evid. II.7 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019 Evid. II.9 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022 Evid. II.22 Miratimi i literaturës bazë në DMIF 2020-2021 Evid. II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22 Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21 Evid. II.30 Vendim Senati Akademik për lëndën Manaxhim projektsh

	Evid. II.32 Përfshirja në planet mësimore e materialeve në kuadër të projektit TeComp			
Konkluzione	<i>Institucioni përmban të gjithë informacionin e nevojshëm ligjor të parashikuar për mbarrëvajtjen e një programi studimit. Përmbajta e tyre jo gjithmonë është e azhurnuar apo në përputhje me objektivat formuese të këtij programi.</i> <i>Ndarja e lëndëve në kategori, sipas VKM 41 e ndryshuar, nuk përkon me objektivat formuese të këtij programi. Kjo ndarje, edhe pse formale, është e nevojshme të rishikohet nga institucioni.</i> <i>Rregullorja e programit të studimit është e plotë dhe në përputhje me aktet e tjera të brendshme rregullatore të institucionit. Në të është përcaktuar një kriter kushtëzues për njohjen dhe transferimin e krediteve me një ngjashmëri së paku prej 80%. Institucione të tjera të arsimit të lartë, për të njëjtin rregull, përdorin kriter më pak kushtëzues, duke kërkuar një ngjashmëri prej së paku 70%. Sugjerohet institucioni që kriteri i njohjes së transferimit të krediteve të jetë së paku 70% ngjashmëri.</i> <i>Edhe pse institucioni realizon periodikisht procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, specifikisht për këtë program studimi nuk rezulton një rishikim cilësor planit mësimor, syllabuseve apo objektivave të të nxënës. Në veçanti, për lëndët karakterizuese vërehet përdorimi i një literature të vjetërsuar dhe jo koherente me objektivat e të nxënës për një program të tillë studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,	Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve janë në përputhje me objektivat formuese të këtij programi studimi, megjithatë, shpërndarja e tyre në semestër dhe vite akademike, jo

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

31 / 108

thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	gjithmonë është e duhura për përcimin gradual dhe progresiv të njohurive (shih Standardin II.3 më sipër). Lëndët në tërësi, përcojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Lëndët të cilat kanë të nevojshme aftësimin laboratorik dhe zhvillohen në ambiente laboratorike ndihmojnë aftësimin e studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit duke i formuar si kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës. <i>Mungesa e praktikave profesionale që të mund të realizohen pranë institucioneve publike apo private shihet nga GVJ si një mangësi për të rritur punësimin e studentëve dhe në përvetësimin e njohurive sipas nevojave të tregut të punës.</i> Megjithatë, personeli akademik është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive praktike studentëve dhe kjo vërehet edhe në takimin me studentët, ku prej tyre u konfirmua impenjimi i stafit akademik në orë praktike si në laborator ashtu edhe në punime individuale të studentëve. Institucioni ka në funksion një sërë marrëveshjes institucionale, por kapacitetet e tyre nuk janë shfrytëzuar plotësisht në funksion të programit të studimit, aq më tepër që plani mësimor nuk parashiko një lëndë praktike. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënit.	Nga analiza e lëndëve, syllabuseve dhe shpërndarjes së tyre gjatë viteve akademike, vërehet se programi i studimit bachelor në “Teknologji Informacioni”, i ofruar në Universitetin e Gjirokastrës, ka ngjashmëri me programe ekuivalente të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Megjithatë, vërehet që disa lëndë kanë përmbajtje jo plotësisht të koordinuar brenda këtij programi. Këtu përmendim lëndët si më poshtë: – “Programim 1” e cila zhvillon argumente në C++ (të orientuara nga objektet).
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	– “Hyrje në sisteme Programimi” zhvillon njohuri në gjuhën C. – “Programim Object Oriented” zhvillon njohuritë në C#. – “Strukturë të dhënash” zhvillon argumentet në C. – “Programim 2” zhvillon argumentet në C#

	– “Gjuha Assembly” (lëndë me zgjedhje), edhe pse në profilin e këtij programi studimi, nuk gjendet e trajtuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë në programe të ngjashme. Lëndë që trajtojnë argumenta të ngjashëm, por duke përdorur gjuhë të ndryshme programimi, dhe disa prej tyre zhvillohen paralelisht në të njëjtin semestër, në vitin e parë. Kjo mund të jetë burim paqartësie dhe ngatërrimi sidomos për studentët e këtij viti. Gjithashtu, lënda “Programim 2”, në vitin e dytë, në argumentet që trajton, është edhe ndërveprimi me bazat e të dhënave. Por studenti njohuritë e bazave të të dhënave i fiton në vitin e tretë. <i><u>Sugjerimë institucionin të koordinojë lëndët dhe përmbajtjen e tyre në harmoni me objektivat formuese të programit të studimit duke maksimizuar edhe rendimentin e përcimit të njohurive në shkallë graduale rritëse tek studentët.</u></i> Ndarja e lëndëve në kategori formuese sipas VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar, nuk është plotësisht në përputhje me objektivat formuese të lëndëve të veçanta në kuadër të objektivave formuese të këtij programi studimi. Disa lëndë janë parashikuar si lëndë të “Formimit bazë” kur përmbajtja dhe përvetësimi i tyre kërkon njohuri të lëndëve të përcaktuara në “Formim karakterizues”. Pra në analizën logjike të ndarjes së lëndëve të një programi studimi, nuk mund të jetë lëndë e formimit bazë, një lëndë e cila për tu përvetësuar, ka nevojë lëndët e formimit karakterizues. Kjo, edhe pse një ndarje formale e lëndëve në kategori, është e nevojshme edhe për të përcaktuar në vijim të zhvillimit të këtij programi studimi, se cilat njohuri janë thelbësore dhe karakterizuese në formimin profesional të studentëve, sikurse është paraqitur edhe në Standardin II.1 më sipër. <i><u>Sugjerimë që institucioni të rishikojë shpërndarjen e lëndëve në kategorit formuese të parashikuara në VKM 41 e modifikuar, në përputhje me objektivat e këtij programi studimi.</u></i> Nëse i referohemi planit mësimor të paraqitur në tabelat 10 në RVB dhe konkretisht planit mësimor, vërehet që lëndë me 5, 6 apo 7 kredite ECTS, zënë në auditor po 30 orë për leksione, pra ngarkesë të barabartë në auditor, pavarësisht peshës së ndryshme në kredite ECTS, apo nevojës për përcaktimin e
--	--

	orëve laboratorike. Sikurse është paraqitur në Standardin II.1 më sipër. <i><u>Sugjerojmë që institucioni të mbajë një ndarje uniforme të ngarkesës për kredit në auditor për secilin aktivitet, si p.sh. X orë në auditor/kredit laborator; Y orë në auditor / kredit seminari, etj. Nëse për secilën lëndë specifike, gjykohet se studenti duhet të ketë një formim më të thellë për këtë aktivitet, të rrisë peshën e tij në kredite, çka automatikisht përkthehet në numër orësh në auditor.</u></i> Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, vërehet si institucioni nuk ka përcaktuar ndarjen në kredite ECTS brenda lëndëve për aktivitetet e nevojshme didaktike si Leksione, Seminare apo laborator dhe projekte/detyra kursi. Nga kjo vërehet edhe mungesa në mënyrë të detajuar të orëve laboratorike të nevojshme për përvetësimin e disa prej lëndëve karakterizuese të këtij programi. Ku në totalin e 4500 orë mësimnxënies për këtë program, vetëm 90 orë janë parashikuar si aktivitete laboratorike, përkatësisht në lëndën e “Fizikës” (30 orë), në lëndën “Programin Object Oriented” (30 orë) dhe Bazë të Dhënash (30 orë). Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u vu në dukje, se edhe në lëndë të tjera të këtij programi studimi, zhvillohen aktivitete laboratorike, brenda orëve të parashikuara në auditor, pavarësisht se ato nuk janë të përcaktuara qartazi në planin mësimor. Gjithashtu, duke patur parasysh edhe numrin e ulët të studentëve në këtë program studimi, zhvillimi i aktiviteteve laboratorike është i gërshtuar me ato të ushtrimeve/seminareve. Megjithatë, duke qenë se plani mësimor, është një informacion publik i cili paraqet në formë të përmbledhur kapaciteteve formuese të çdo programi studimi, ai duhet të paraqesë qartazi aftësitë dhe kompetencat që ofron, si për studentët aktual, ashtu edhe për kandidatët për student në këtë program studimi në vijim. Gjithashtu, plani mësimor së bashku me plan programet lëndore, janë një nga dokumentacionet bazë që shoqërojnë formimin e studentëve, sidomos në rastet e transferimit të krediteve nga ky institucion drejt një institucioni tjetër. Mos paraqitja e plotë apo e qartë e ndarjes së lëndëve në aktivitete formuese, si në kredite ashtu edhe në orë mësimore përkatëse, mund të vështirësojnë njohjen e krediteve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi studimi kur transferohen në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.
--	--

	Përcaktimi i krediteve për çdo aktivitet didaktik ndihmon jo vetëm studentin për të baraspeshuar shpërndarjen e orëve të studimit për lëndë dhe aktivitete të saj, por shërben edhe për stafin akademik mësimdhënës për të vlerësuar edhe peshën që laborator apo detyra/projekti duhet të kenë në vlerësimin përfundimtar. Gjithashtu, një ndarje e aktiviteteve formuese, gjithmonë, brenda lirisë akademike të stafit mësimdhënës, i lejon edhe institucionit të monitorojë dhe të ketë instrumente sasiore vlerësues të stafit në impenjimin e tij me studentët, por edhe të vlerësojë nevojën për infrastrukturë në mbështetje të programit të studimit. Pra përcaktimi i krediteve për aktivitetet laboratorike, dhe orëve përkatëse, i mundësojnë institucionit të vlerësojë në mënyrë sasiore oraret dhe mjaftueshmërinë e ambienteve laboratorike dhe kapacitetet maksimale që ato kanë për tu shfrytëzuar <i>Institucioni të rishikojë hartimin e planit mësimor, duke përcaktuar qartazi të gjitha aktivitetet didaktike formuese (Leksione, seminare/ushtrime, laborator, projekte/detyra kursi, etj) të nevojshme për përvetësimin e njohurive për secilën lëndë.</i> 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Mungesa e një ndarje të qartë të aktiviteteve didaktike, potencialisht mund të jetë një vështirësi në transferimin e studimeve nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, drejt institucioneve të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Kjo pasi mungesa e këtij informacioni në planin mësimor dhe në syllabuse, mund të pengojë apo vështirësojë proceset e ekuivalentimeve në institucionet e arsimit të lartë të cilët përdorin ndarjen në kredite ECTS për të gjitha aktivitetet didaktike. <i>Sugjerojmë institucionin të rishohë planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve duke përcaktuar qartazi kreditet ECTS dhe orët në auditor për secilin aktivitet didaktik.</i> 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe

/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	drejtuesin e njësishë bazë, GVJ evidentoi praktikën e analizës mësimore periodike për të gjitha lëndët e mbuluara nga stafi i kësaj njësie në tërësi, ku në të përfshihet edhe analiza e planeve mësimore dhe syllabuseve të lëndëve përkatëse. Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit parashtrohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me drejtuesin e njësishë bazë, dhe pasi miratohet në departament ndjek procedurat institucionale të miratimit në senatin akademik dhe më pas në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Megjithatë institucioni e ka të parashikuar procedurën e brendshme të rishikimit të programeve të studimit dhe planeve mësimore përkatëse, specifikisht për këtë program studimi nuk ka evidenca të rishikimit të tij. Edhe plan-programet e lëndëve, sidomos ato të formimit karakterizuese, janë me literaturë të vjetëruar dhe jo më koherente për objektivat formuese, përfshirë këtu, literaturë të viteve 2007 deri në 2012. Ndërsa për lëndët e formimit bazë, si ato me formim kryesisht në profilin matematikë dhe fizikë, duke qenë ky një program studimi i nivelit të parë bachelor, argumentat e trajtuara në këto lëndë janë klasike në këto fusha. Pikërisht për këtë motiv, edhe trajtimi i tyre me literaturë jo të viteve të fundit, nuk përbën asnjë problem cilësor. <i><u>Sugjerojmë institucionin, që së paku, për lëndë karakterizuese të këtij programi, literatura të azhurnohet me edicione të viteve të fundit.</u></i> 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.22 Miratimi i literaturës bazë në DMIF 2020-2021
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni, në tërësinë e tij, garanton përfitim të njohurive, aftësive themelore (aftësive teknike dhe aftësive të tjera), si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.17 Misioni i Programit të Studimi Bachelor në Teknologji Informacioni
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit	Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe / ose punësimin e studentëve në

mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësimit të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në kompani si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Edhe nga studimi që ka bërë institucioni, rezulton një pritshmëria e lartë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi. Institucioni nuk ofron një vazhdim të ciklit pasardhës (Master) të studimit të drejtëpërdrejtë për këtë program studimi. Kjo shihet nga studentët si një pengesë për zgjedhjen e këtij programi të ofruar nga Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastër. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.17 Misioni i Programit të Studimi Bachelor në Teknologji Informacioni
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i këtij programi studimi, është i ngjashëm me ato të ofruara nga IAL të tjera, edhe pse për disa lëndë është e nevojshme rishpërndarja në vite akademike për të garantuar një përçim më organik dhe gradual të dijeve.</i> <i>Plani mësimor është i kategorizuar sipas VKM 41 e ndryshuar, por ndarja e lëndëve në këto kategori nuk përkon me objektivat formuese të këtij programi, prandaj këshillohet institucionit të rishikojë shpërndarjen e lëndëve në kategori formuese.</i> <i>Ndarja e orëve në auditor për lëndë nuk bazohet mbi kreditet e lëndëve. Institucioni për lëndë me pesha të ndryshme në kredite ECTS (6, 7 apo 8 ECTS) dhe të të njëjtës kategori formuese, zenë në auditor të njëjtët numër orësh, duke mos patur kështu si njësi matëse të përçimit të dijeve, kreditin ECTS.</i> <i>Në planin mësimor por edhe në plan-programet e lëndëve, nuk janë të përcaktuara ndarjet në kredite të aktiviteteve didaktike formuese Leksione, seminare/ushtrime, laborator, projekte/detyra kursi, etj) të nevojshme për përvetësimin e njohurive për secilën lëndë.</i> <i>Institucioni duhet të rishikojë në tërësi hartimin e planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, duke balancuar numrin e orëve në auditor në përpjesëtim të drejtë me peshën në kredite ECTS që secili aktivitet didaktik (leksione, seminare, laboratorë etj..) ka.</i> <i>Literatura dhe rishikimi i përmbajtjes së programit të studimit edhe pse ndiqet si procedurë nga institucioni në mënyrë</i>

	<i>periodike, nuk është efektive, pasi nuk ka sjellë ndryshime cilësore të nevojshme në përmbajtjen e tij.</i> <i>Institucioni duhet të rishikojë efektivisht në mënyrë periodike përmbajtjen e planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, duke garantuar së paku rishikimin e literaturës për lëndët e formimit karakterizues.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Institucioni është i angazhuar në përfshirjen e studentëve dhe aktorëve të jashtëm në hartimin apo rishikimin e programeve të studimit që ofron. Në mënyrë periodike realizohen edhe takime me studentët si për këshillimin e karrierës ashtu edhe për marrjen e mendimeve dhe opioneve të nevojshme për përmirësimin në vijim të ofertës didaktike. Institucioni përdor edhe shkëmbimet e stafit akademik me institucione të tjera të arsimit të lartë, si brenda vendit edhe jashtë, ku përvoja e marrë nga këto shkëmbime, shërben edhe si bazë e përmirësimit në vazhdim të ofertës didaktike. Megjithatë, nga institucioni pranohet si një mungesë e aktorëve të biznesit në rajonin e Gjirokastrës, specifikisht në objektivat e këtij programi studimit. Kjo sjell që edhe propozimet apo opinionet e sjella nga tregu i punës lokal, të jenë shumë të vogla. Evid. VI.7 Takime me studentët Këshillimi i Karrierës Evid. V.13 Formular kontakti Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës-Student Evid. V.13.1 Korrespondenca- Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës Evid. III.15.4 Listë me personat që kanë dhënë mësim ose kanë bërë punë kerkimore në një universitet perëndimor Evid. III.15.5 Liste e profesoratis të huaj të angazhuar në dhënien e titujve në UGJ
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime	Në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale konform statutit dhe

studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	rregullores. Institucioni përfshin opinionet e studentëve në diskutimet e brendshme të njësive bazë për përmirësimin e vazhduar të programeve që ofrohen. Institucioni përdor me efikasitet edhe metodat e komunikimit “sociale” midis studentëve dhe institucionit, përfshirë këtu komunikimet online në rrjete sociale të zyrës së këshillimit të karierrës apo alumni. Studentët në këtë institucion janë të organizuar edhe në shoqata sportive, çka vlerësohet si shumë pozitive për të rritur rolin e universitetit në komunitet jo vetëm si institucion i përcimit të dijeve por edhe si njësi qendrore sociale, kulturore dhe shoqërore. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. II.24 Statuti i Këshillit Studentor Evid. V.8 Rregullore e organizimit të zgjedhjeve për Këshillin Studentor Evid. V.9 Statuti i shoqatës sportive UGJ
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, realizon në mënyrë të përvitshme një analizë në tërësi të aktivitetit të saj, përfshirë edhe atë të nevojave për përmirësim të vazhduar të ofertës së saj didaktike. Njësia bazë përfshin edhe aktor të jashtëm në procesin didaktik, duke përmendur edhe seminare apo orë të hapura të realizuar nga specialist të fushës nga tregu i punës apo edhe nga realizimi i projekteve kërkimore shkencore që zhvillohen pranë institucionit. Këtu përfshihen edhe hartimi i strategjive me objektivat të qartë cilësor, si në nivel njësie bazë, asaj kryesore dhe institucionale. Por në asnjë prej këtyre strategjive të hartuara, nuk gjenden mekanizma efektiv se si mund të arrihen ato objektive, as afate kohore të arritjes së tyre, por as edhe mekanizma të matjes së arritjes së objektivat të paracaktuar. <i>Institucioni, përveçse të hartojë strategji në tre nivele institucionale, duhet të hartojë edhe mekanizmat të qarta për arritjen e tyre, dhe për monitorimin e arritjeve.</i> <i>Këtu të përfshihet së paku edhe mekanizmi i rishikimit të planeve mësimore dhe përmbajtjeve të lëndëve në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e këtij programi studimi.</i> Evid. III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies Evid. I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 19-20, 20-21, 21-22

	Evid. I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 19-20, 20-21, 21-22 Evid. I.21.1 Plani i veprimit për Akreditimin Institucional periodik Evid. I.21.2 Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e planit të veprimit Evid. I.26 Leksione të hapura Evid. I.28 Raport projekti TeComp Evid. I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie Evid. I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies Kompetencat Didaktike (TeComp) Evid. II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ Evid. II.32 Përfshirja në planet mësimore e materialeve në kuadër të projektit TeComp Evid. III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online Classroom Evid. III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeeet Evid. III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365			
Konkluzione	<i>Institucioni parashikon dhe harton marrëveshje me aktor të tregut të punës specifikisht për këtë program studimi, por angazhimi dhe kontributi i tyre në rishikimin e programit të studimit është shumë i vogël. Kjo edhe për faktin se në rajonin e Gjirokastrës nuk ka aktor apo aktivitete tregtare që kanë objektiv parësor zhvillimin e teknologjisë së informacionit.</i> <i>Edhe pse me vështirësi objektive të aktorëve lokal, institucioni duhet të garantojë rishikimin e planeve mësimore, bazuar edhe në eksperiencat e institucioneve partnere si kombëtare edhe ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë një kombinim i metodave tradicionale me ato bashkëkohore të vlerësimit përfundimtar të studentit. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e mësimin, projekteve, detyrave, praktikave, seminarëve dhe punëve të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse të orës së performuar në auditor. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga numri total i orëve javore të parashikuara për lëndët. Gjatë një viti akademik plotësohen të paktën 60 Kredite ECTS. Studentët vlerësohen mbi bazën e provimeve të ndërmjetme; provimeve finale; detyrave; prezantimeve dhe projekteve. Metodatat e vlerësimit janë të shprehura qartë në syllabusin e çdo lënde dhe çdo lektor organizon përqindjen e vlerësimit për secilën pjesë. Llojet e vlerësimit janë: detyrat, kolektimet, kuizet, projektet, projektet semestrale, pjesëmarrja në mësim, provimet e ndërmjetme dhe provimet finale. Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019 Evid. III.1.1 Implementimi i platformës së mësimin online Classroom Evid. III.1.2 Implementimi i platformës së mësimin online Edumeeet Evid. III.1.3 Implementimi i platformës së mësimin online Office 365 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22 Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi	Personeli akademik monitoron me kujdes rastet specifike dhe gjithmonë përpiqet të identifikojë kërkesat e studentëve që mund të kenë nevojë. I gjithë personeli akademik dhe ndihmës akademik i njësisë bazë është i disponueshëm për të ndihmuar studentët si në aktivitetet e tyre didaktike, ashtu edhe në

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

41 / 108

alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	zhvillimin e projekteve individuale. Për këtë qëllim, vendosin në dispozicion edhe laboratorët dhe ambientet e institucionit. Gjithashtu, për të paraqitur në një këndvështrim plotësues për studentët, njësia bazë dhe ajo kryesore marrin pjesë edhe në aktivitete shkencore si konferenca apo orë të hapura ku studentët ftohen të marrin pjesë. Evid. I.26 Leksione të hapura Evid. I.28 Raport projekti TeComp Evid. I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie Evid. I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies Kompetencat Didaktike (TeComp) Evid. III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online Classroom Evid. III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeeet Evid. III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365 Evid. III.1.11 Orari konsultimeve Evid. III.1.12 Orari mësimi online 2020-2021 Evid. III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies Evid. III.5.4 Vendim SA për miratimin e udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.	Institucioni demonstroi se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike. Për këtë qëllim mbështet organizimin e aktiviteteve shkencore si konferenca të organizuara nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera. Gjithashtu stafi akademik këshillohet të marrë pjesë në aktivitete të tjera shkencore, por në këto raste, mbështetja ekonomike e institucionit është thuajse e papërfillshme ose mungon krejtësisht. Në shumicën e rasteve për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë vendit, stafi akademik i mbulon vetë shpenzimet, ose në rastin më të mirë, mbështetet nga institucionet partnere. Kjo sjell një barrë të lartë ekonomike dhe një pengesë shumë të madhe për stafin akademik për të përparuar në karrierën akademike dhe atë shkencore. <i>Institucioni të rris dhe mbështes kualifikimin e stafit akademik për të garantuar së paku staf të kualifikuar në nivel doktorat.</i> Evid. III.15 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2019-2020

	Evid. III.15.1 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2021-2022 Evid. III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023 Evid. III.15.3 Plani i veprimtarisë së DMIF 2019-2020 Evid. IV.16.4 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025 Evid. IV.16.5 Kërkesë nga Administratori për projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Programi i studimit mbulohet në masën më të madhe nga personel akademik i institucionit në tërësi. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në lëndët që mbulojnë dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie. Edhe pse një pjesë e stafit akademik me kualifikimin “Master i Shkencave”, kanë një përvojë të gjatë mbi 10-vjeçare në këtë institucion si lektor/asistent lektor. Stafi si efektiv (PAE) ashtu edhe ai me kontratë (PAK) që angazhohet në mësimdhënie, angazhohet në përcimin e dijeve duke përdorur metodat interaktive, sidomos në lëndët karakterizuese, të cilat, duke qenë numri i studentëve i ulët, zhvillohen tërësisht në ambient laboratorik. <i>Institucioni të rris dhe mbështes kualifikimin e stafit akademik për të garantuar së paku staf të kualifikuar në cikline e tretë “Doktoratë”.</i> Evid. III.4 CV-të e Personelit Akademik dhe ndihmës akademik Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online Classroom Evid. III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeet Evid. III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë	Bazuar në DVV dhe informacioni përgjatë vizitës në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, konstatohet se njësia përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies se personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë. Drejtuesi i njësisë bazë analizon në fund të çdo semestri performancën e çdo anëtar të departamentit dhe me pas kontakton çdo anëtar për të shprehur

studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	gjetjet dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm. Nga ana tjetër institucioni ka zhvilluar mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, duke përcaktuar edhe rregulloret përkatëse për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë. Në hartimin e këtyre raporteve përfshihen edhe mendimet e studentëve të mbledhura kryesisht me anë të pyetësorëve. Megjithatë, sikurse u evidentua edhe gjatë takimeve në institucion, plotësimi i pyetësorëve në tërësi, është në një numër të ulët nga totali i studentëve. Edhe pse institucioni i ka të përcaktuara në strategjitë e zhvillimit dhe rritjes së cilësisë së brendshme, vlerësimin e mendimeve të studentëve dhe pasqyrimin e tyre në ndryshimet e mundshme të planeve mësimore, GVJ nuk gjeti evidenca të zbatimit të tyre konkretisht në këtë program studimi. Strategjitë në tërësi përshkruajn objektiva që duhet të arrihen në përmirësimin cilësor të programeve të studimit në veçanti dhe të të gjitha shërbimeve të ofruara nga institucioni në tërësi. Por nuk gjenden mekanizma se si objektivat e përshkruara në strategji do të arrihen, as mënyra apo mekanizma monitorimi të arritjeve apo mos arritjeve të objektivave strategjik. Kjo përkon edhe me faktin se në objektivat e njësive bazë përcaktohet përmirësimi i planeve mësimore dhe syllabuseve lëndore, por nuk ka asnjë mekanizëm se si do të arrihen këto objektiva dhe as kritere matëse të tyre. Kjo edhe në përputhje me gjetjet e përshkruara në standrdin II më sipër, ku plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve nuk rezultojnë të jenë përditësuar as në përmbajtje as në literaturë. <i><u>Sugjerjojmë institucionin të hartojë përtej objektivave strategjikë, edhe kritere apo mundësi për arritjen e tyre dhe të monitorojë efektivisht efikasitetin e këtyre mekanizmave.</u></i> Evid. III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete Evid. V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantë Evid. V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	Bazuar në dokumentacioni e paraqitur nga institucioni, vërejmë se janë së paku dy struktura në nivel institucionale që kanë në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës akademike, që janë: – Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave

mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	– Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë – Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë Struktura/zyra që janë pjesë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës-akademike dhe administrative. Aktiviteti i tyre në tërësi shtrihet në hartimin e udhëzuesve apo objektivave strategjik të zhvillimit institucional si dhe në koordinimin administrativ të kurrikulave, planeve mësimore etj., konform akteve ligjore në fuqi. Por mbetet objekt i njësive bazë koordinimi dhe hartimi i mekanizmave cilësor në përmirësimin e vazhduar të përmbajtjes së planeve mësimore. Edhe njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë (NJSBC), e ngritur në nivel institucional, në rregulloren e saj ka të përcaktuar objektivat që duhet të arrijë, por nuk ka të përcaktuar mekanizmat se si mund të realizojë ato objektiva. Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC Evid. VI.8.1 Vendim Senati për miratimin e NJSBC në UGJ Evid. I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025 Evid. I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 19-20, 20-21, 21-22 Evid. II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ Evid. III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies			
Konkluzione	<i>Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, ka të ngritur njësi që kanë në fokus monitorimin e brendshëm të cilësisë, përfshirë edhe studentët si një hallkë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë.</i> <i>Kryesisht këto njësi kanë rol në mbledhjen dhe raportimin e gjetjeve që duhet të përmirësohen, dhe duke hartuar raporte apo ndihmuar në hartimin e objektivave strategjik, po pa krijuar mekanizma për rritjen e cilësisë dhe monitorimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloret institucionale, në veçanti neni 10 i rregullores së programit të studimit, “Vlerësimi dhe kontrolli i studentëve”. Informacionet për çdo lëndë, për mënyrën e vlerësimit dhe peshat që çdo aktivitet si laborator, frekuentim apo projekt, zënë në vlerësimin total, paraqiten në syllabuset e lëndëve. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021 Evid. III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021 Evid. III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021 Evid. III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstaton se në Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, bazuar në specifikat e secilës lëndë. Forma të cilat janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit. Informacion të hollësishëm studentët përveç informimit nga pedagogu i lëndës gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve, ku në varësi të natyrës së lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar të cilat i bëhen të ditura studentit. Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22

	Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, specifike për çdo lëndë. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: provimi i ndërmjetëm, niveli i pjesëmarrjes në seminare, detyra kursi dhe provimit përfundimtar. Në takimin me studentët na konfirmuan që përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të aftësive dhe talenteve të tyre, dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor. Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22 Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21 Evid. III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe në takimet me studentët e këtij programi studimi, vihet re se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Vlerësime që më pas bëhen pjesë e analizës në njësinë bazë dhe nëse gjykohen, përdoren për përmirësimin në vazhdim të shërbimeve të ofruara nga njësia bazë dhe ajo kryesore për studentët. Evid. II.24 Statuti i Këshillit Studentor Evid. II.25 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor Evid. III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit Evid. III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete Evid. IV.13 Kërkesë për blerje librash Evid. VI.5 Sondazhi Kombëtar i Studentëve Evid. VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në	Institucioni mundëson metoda të ndryshme mësimdhënëse, duke përfshirë ato klasike në auditor si dhe ato online të përforcuara gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e virusit Sars-Cov-19. Në metodat në auditor të mësimdhënies, përfshihen leksionet, seminarët dhe laboratorët. Në veçanti, duke patur edhe një numër të vogël të studentëve të regjistruar

përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	në këtë program studimi, institucioni zhvillon seminarët e disa prej lëndëve karakterizuese në ambiente laboratorike duke gërshtuar kështu pjesën teorike me zbatime dhe simulime praktike. Gjithashtu studentët motivohen për projekte praktike individuale apo punime në grup, punime të cilat prezantohen përpara pedagogut të lëndës dhe studentëve të tjerë që frekuentojnë atë lëndë. Kjo mundëson zhvillimin e autonomisë së studentit i cili jo vetëm përvetëson njohuritë, por mëson edhe ti përçojë ato. Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021 Evid. III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online Classroom Evid. III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeeet Evid. III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365			
Konkluzione	<i>Institucioni ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloret institucionale, në veçanti neni 10 i rregullores së programit të studimit, "Vlerësimi dhe kontrolli i studentëve". Informacionet për çdo lëndë, për mënyrën e vlerësimit dhe peshat që çdo aktivitet si laborator, frekuentim apo projekt,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

48 / 108

vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	zenë në vlerësimin total, paraqiten në syllabuset e lëndëve. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve janë ato të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit, përfshirë vlerësimin e vazhduar gjatë lëndës në një masë jo më të madhe se 20% dhe atë të provimit përfundimtar në masën 80%. Institucioni gjithashtu ka në përdorim edhe vlerësimin e dijeve me anë të sistemit të automatizuar "CleanScore" të mundësuar në bashkëpunim me AADF. Mekanizëm ky që mundëson një vlerësim elektronik të rezultateve, bazuar në pyetësor. Megjithatë, ky mekanizëm vlerësimi nuk është gjerësisht i përhapur në vlerësimin e dijeve të studentëve të këtij programi studimi. Evid. III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021 Evid. III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021 Evid. III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021 Evid. III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Në takimin me studentët e këtij programi studimi, studentët konfirmuan se mënyra e vlerësimit të njohurive u bëhet e ditur nga pedagogu i lëndës që javën e parë të leksioneve dhe përsëritet javën e fundit të semestrit. Në javën e fundit të semestrit, pedagog i lëndës informon studentët rreth vlerësimit të tyre paraprak të vazhduar, si dhe të drejtën apo jo për të marrë pjesë në provimin përfundimtar të lëndës. E drejtë që lind mbas shlyerjes së detyrimeve lëndore si frekuentimi i seminareve, shlyerja e laboratoreve apo edhe i detyrave të kursit për lëndët që i parashikojnë. Mënyra dhe forma të vlerësimit të cilat janë të paraqitura edhe në syllabusin përkatës të lëndës si dhe në rregulloret institucionale. Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23

	Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021 Evid. III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021 Evid. III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021 Evid. III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregulloreve në fuqi të institucionit. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen njohuritë dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Edhe në korrigjimin e provimeve, ato shoqërohen me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe motivin e vlerësimit. Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Për këto të fundit, përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës. Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar dhe Kodit të Etikës. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

	Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem në bazë notash nga 1 në 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve pedagogu i lëndës në orën dhe sallën e dakordësuar paraprakisht me studentët. Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, quiz-e, prezantime në grup ose individuale, etj. Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim sikurse është e saktësuar edhe në rregulloren e Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës duke paraqitur kërkesë pranë Dekanit të njësisë kryesore ku ndjek programin e studimit. Kërkesë që shqyrtohet dhe nëse pranohet, analizohet nga një komision <i>ad-hoc</i> i ngritur me pedagog të lidhur me disiplinën që po vlerësohet. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi, u vu re se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo qartësoshin rreth çdo paqartësie të mundshme direkt me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Studentët vunë në dukje disponibilitetin e pedagogëve për sqarime dhe këshillime të studentëve. Evid. I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë

	Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni			
Konkluzione	<i>Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimeve apo nevojave për qartësime të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë teorike në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe përmbyllet me punimin e diplomës. <i>Megjithatë, vërehet mungesa e një lënde/moduli "Praktikë Profesionale" e cila do të ndihmonte studentin të vinte në praktikë njohuritë e përfuara në një ambient real në tregun e punës.</i> Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Staf i akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Kjo kurrikulë parapërgatit studentet për thellimin e studimeve në ciklin master. Nga shqyrtimi i plan-programeve të lëndëve vërehet se nuk janë parashikuar qartë orët laboratorike dhe ato të ushtrimeve, të cilat sipas institucionit janë të përfshira në ngarkesën e orëve totale në auditor bashkarisht me orët e seminareve. Kjo duke parë numrin e ulët të studentëve në këtë program studimi. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019 Evid. II.17 Misioni i Programit të Studimi Bachelor në Teknologji Informacioni

	Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit garanton zhvillimin e veçantë në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Për sa më sipër, në planin mësimor të këtij programi studimi, janë të parashikuara zhvillimi i lëndëve karakterizuese në teknologjinë e informacionit dhe janë parashikuar gjithashtu edhe lëndë me karakter të përgjithshëm dhe menaxherial (Shkrim dhe Menaxhim Projektsh), apo të formimit gjuhësor (Gjuhë e Huaj), etj. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Referuar takimit me stafin akademik dhe me studentët, GVJ konstaton se në javët e fundit, pedagoget e lëndës informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale vlerësimet e fituara gjatë semestrit. Studentët orientohen edhe në përfundim të tre viteve të universitetit, rreth strukturës dhe tipologjive të pyetjeve që do të jenë pjesë e provimit përfundimtar. Në këtë mënyrë studentët orientohen rreth argumentave dhe çështjeve më të rëndësishme që duhet të jenë përvetësuar prej tyre për të kaluar me sukses edhe provimin e fundit përmbyllës. Evid. III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.11.1. Miratimi i fushave të studimit Evid. III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe	Institucioni garanton qasje në laboratorët e teknologjisë së informacionit, për studentët e këtij programi studimi. Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e ndarë qartë aktiviteti laboratorik nga ai i leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i lëndëve karakterizuese në ambiente të pajisur me PC, ku krahas

punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	analizës teorike, zhvillohen edhe aplikimet praktike në simulime, programim etj. Edhe nga stafi akademik, u vu në dukje, se zhvillimi i seancave laboratorike janë të gërshetuara me ato teorike (Leksione, seminare/ushtime) të cilat studenti motivohet ti zbatojë praktikisht në aktivitet laboratorik. Stafi akademik i njësisë bazë angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca, simpoziume dhe workshope, si dhe mundëson zhvillimin e orëve të hapura nga pedagog të ftuar pranë këtij institucioni Stafi akademik i njësisë bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, organizon diskutime me studentët rreth argumentave kryesorë që do të jenë pjesë e provimit përfundimtar. Gjithashtu, stafi akademik paraqet tek studentët edhe për mundësitë e punësimit të tyre, u prezanton pjesëmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon grupe pune studimore me pjesëmarrjen e studentëve duke u paraqitur edhe mundësitë që ekzistojnë për programet e shkëmbimit të studentëve me institucionet partnere. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019 Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Përgjatë vitit akademik, njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët e saj. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor. Evid. I.26 Leksione të hapura Evid. I.28 Raport projekti TeComp Evid. I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie			
Konkluzione	<i>Njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi të ofertës akademike duke realizuar në mënyrë të vazhduar takime, seminare, workshop-e, në kuadër të bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Institucioni parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e njësisë kryesore dhe ajo e njësisë bazë paraqesin qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi. Procedura më specifike për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve gjenden në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni. Komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës caktohen nga Përgjegjësi i njësisë bazë dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit në bashkëpunim me anëtarët plotësojnë një program tematikash për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, ku hartimi i pyetjeve specifike realizohet nga stafi i brendshëm akademik dhe vihen në dispozicion të studentëve. Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019 Evid. III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.11.1. Miratimi i fushave të studimit Evid. III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e	Përgjegjësi për mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik, përfshirë edhe diplomimin e studentëve, është njësi bazë, Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës. Kjo njësi harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një fond pyetjesh orientuese për studentët për përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar të diplomimit. Fond pyetjesh që u vihen

nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	studentëve në dispozicion në zyrën e informimit pranë njësisë kryesore. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019 Evid. III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.11.1. Miratimi i fushave të studimit Evid. III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në rregulloret e institucionit, GVJ konstaton se Teza e Provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i provimit përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtarë bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar. Tezat e provimit, të hartuara si më sipër, miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe nga ai i njësisë kryesore. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019 Evid. III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.11.1. Miratimi i fushave të studimit Evid. III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton	Ky program studimit mbyllet me provim përfundimtar, departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës si dhe njësia kryesore FSHN angazhohen maksimalisht me mbarëvajtjen e tij. Studentët asistohen në konsultime që zhvillohen në periudha të caktuara në varësi të nevojave të tyre, gjithashtu institucioni u vë në dispozicion edhe salla studimi, mjediset laboratorike për përvetësimin e tematikave specifike. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

56 / 108

cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Evid. III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.11.1. Miratimi i fushave të studimit Evid. III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Procedura e diplomimit për studentët e këtij institucioni është e hartuar qartë në rregulloret e ndryshme që janë hartuar në nivel institucioni, njësie kryesore dhe asaj bazë. Provimi përfundimtar ose projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomës. Vlerësimi behet në bazë të vlerësimeve të pavarura të anëtareve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidati dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të bëra nga komisioni. Nota komunikohet në prani të komisionit nga kryetari i komisionit. Në rastin e provimit përfundimtar nota del pas vlerësimit të çdo tematike nga anëtari i komisionit përgjegjës për fushën përkatëse Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS zyrtar përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma mbart elementët e përcaktuar dhe miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe lëshohet vetëm njëherë nga institucioni. Institucioni mban kopje të saj dhe studenti mund të pajisjet vetëm me vërtetime në rast humbjeje të saj. Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar kur ai e kërkon këtë gjë. Evid. II.4 Regjistrimi i formës së diplomës për programin Teknologji Informacioni Evid. II.5 Model diplome Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.6 Vendim Senati për miratimin e suplementit

	Evid. II.6.1 Model suplementi i diplomës Evid. II.6.2 Udhëzim Nr.11, dt. 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstatohet se të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizimi i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë. Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore			
Konkluzione	<i>Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, ka të përcaktuar qartë procedurat e mbylljes së studimeve, mbrojtjen e diplomës apo të provimit të formimit.</i> <i>UGJ pajis studentët me diplomën sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet	Personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit përmbush standardet sasiore dhe kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit. Fakulteti

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

58 / 108

në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

i Shkencave të Natyrës gjatë vitit akademik 2022-2023 ka patur në përbërje 3 departamente me së paku 7 personel akademik me kohë të plotë dhe prej tyre të paktën 3 i përkasin kategorisë profesor ose lektor. Si të punësuar me kohë të plotë pranë këtij fakulteti janë 29 personel akademik dhe 5 personel ndihmës akademik. Pjesë e këtij fakulteti është edhe Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës.

Kjo njësi bazë është përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Informacioni" dhe ka në përbërje për tre vite akademike sipas tabelës më poshtë :

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	1	-	1	-	1
Prof. Asoc.	2	-	3	0	3	-
Dr/Phd	5	-	4	1	4	1
Msc.	5	2	4	3	3	2
Total	12	3	11	5	10	4

Angazhimi i personelit akademik në lëndët / modulet e programit të studimit është në përputhje me profilin dhe fushën kërkimore që mbulojnë.

5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse

Evid. III.4 CV-të e Personelit Akademik dhe ndihmës akademik

Evid. I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 19-20, 20-21, 21-22

Evid. I.27 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Gjatë vitit akademik 2022-2023, 90% e ngarkesës së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Informacioni" është mbuluar nga personeli akademik i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, ku mbi 70 % e ngarkesës mësimore është mbuluar nga personeli akademik efektiv i Universitetit "Eqrem Çabej".

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2020-2021	1935	1770	165	91% / 9 %

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

59 / 108

	2021-2022	1915	1540	375	80 % / 20%
	2022-2023	1935	1515	420	78% / 22%
	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, problematikat e evidentuara në lidhje me ngarkesën mësimore të programit të studimit gjatë vitit akademik 2022-2023 (por edhe në vitet e mëparshme akademike) janë kryesisht në lëndët e profilit të informatikës ku: – leksionet mbulohen nga personel akademik i kategorisë asistentë lektor – ka personel akademik me mbi 6 lëndë të ndryshme të mbuluara brenda një viti akademik <i>Për sa më sipër rekomandohet që institucioni të rekrutojë personel akademik me kohë të plotë të kategorisë lektor në profilin e fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.</i> 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse				
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Universiteti “Eqrem Çabej” zotëron të gjithë dokumentacionin për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit të ciklit të parë bachelor në “Teknologji Informacioni”. Dosjet e personelit akademik mirëmbahen nga drejtoria e shërbimeve ndihmës akademike-administrative. Universiteti “Eqrem Çabej” siguron kontrata me afat të pacaktuar për personelin akademik me kohë të plotë të kategorive profesor dhe lektor. Personeli akademik me kohë të plotë i kategorisë asistent lektor punësohet me kontratë me afat të caktuar e cila rinovohet bazuar në kërkesat / propozimet e njësisë bazë dhe në politikat e vetë institucionit. Institucioni siguron edhe pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik efektiv bazuar në legjislacionin në fuqi. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evid. IV.3 Listëpagesa, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik Janar-Maj 2023				
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në	Procedurat e rekrutimit të personelit në Universitetin “Eqrem Çabej” janë të pasqyruara në aktet rregullatore të brendshme dhe respektojnë bazën ligjore në fuqi. Nevojat dhe kriteret për rekrutimin e personelit akademik përcaktohen nga njësi bazë dhe i përcillen Rektorit nga ana e drejtuesit të njësisë kryesore. Në rast se kërkesa miratohet, njoftimi publikohet në buletin e njoftimeve publike si dhe në faqen elektronike zyrtare të Universitetit “Eqrem Çabej”. Vlerësimi i kandidaturave bëhet nga një komision ad-hoc i				

përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	ngritur nga rektori në rastin e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe nga dekani në rastin e rekrutimit të personelit akademik me kohë të pjesshme. Përbërja e komisionit është me shumicë nga njësia bazë e cila ka kërkuar rekrutimin e personelit akademik. Evid. IV.3.1 Model kontratë individuale e punës me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar Evid. IV.3.2 Model kontratë individuale e punës me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar Evid. IV.3.3 Model dosje personeli Evid. IV.4 Propozim për personel akademik me kohë të plotë Evid. IV.4.1 Propozim për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar Evid. IV.4.2 Buletini njoftimeve publike Evid. IV.6 Procedurë e punësimit të personelit akademik në DMIF
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në ndihmë të realizimit të orëve laboratorike dhe mirëmbajtjes së laboratorëve dhe mjediseve mësimore është punësuar edhe një personel ndihmës akademik me karakter mësimor. Ngarkesa e personelit ndihmës akademik propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore. Megjithatë bie në sy zvogëlimi i personelit ndihmës akademik nga 3 anëtarë që ishin vitin akademik 2021-2022 në vetëm një personel ndihmës akademik në vitin akademik 2022-2023. Bazuar edhe në numrin e ulët të studentëve për këtë program studimi, nuk ka rezultuar në një rritje të ngarkesës së aktiviteteve të personelit ndihmës akademik. Megjithatë, institucioni të shohë mundësinë e rritjes së numrit të personelit ndihmës akademik me kohë të plotë. Evid. 9 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akadematike – Administrative Evid. IV.7 Detyrat dhe ngarkesa e personelit ndihmës akademik
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në	Struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në UGJ është Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari-Protokoll. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga GVB si dhe nga vizita në institucion u verifikua se dokumentacioni për dosjet e

përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	personelit akademik ishte i plotë. Dosja e personelit përfshin CV, fotokopje e dokumentit të identifikimit, diplomat, gradat shkencore dhe titujt akademik, dëshmi të gjuhëve të huaja, trajnimet etj. Ndërkohë struktura përgjegjëse për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave për kërkimin shkencor, projektet etj., është Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Ruajtja e këtyre të dhënave bëhet çdo vit akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Evid. IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale Evid. IV.2.1 Rregullore e njehësuar e punës me dokumentet në UGJ Evid. IV.2.2 Vendim Senati Akademik mbi Udhëzuesin për Privatësinë Evid. IV.2.3 Udhëzues mbi Privatësinë
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Programi i studimit nuk parashikon zhvillimin e një lënde / moduli për praktikën profesionale. Përsa i përket zhvillimit të diplomës, të drejtën për të përgatitur një punim / temë diplome e kanë studentët që kanë një notë mesatare të paktën 8. Studentët që nuk e arrijnë këtë prag diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Bazuar në numrin e studentëve aktiv në programin e studimit të ciklit të parë bachelor në “Teknologji Informacioni” dhe numrin e personelit akademik me kohë të plotë të Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, kjo njësi bazë ka personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve për punimin e diplomës. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve	Programi i studimit nuk parashikon zhvillimin e një lënde / moduli të detyrueshëm për praktikën profesionale. <i>Rekomandohet shtimi i lëndës së praktikës profesionale pranë aktorëve të biznesit apo institucioneve publike, me qëllim afrimin e studentëve dhe njohurive të tyre në tregun e punës.</i> Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni

/raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informacioni 2018-2019			
Konkluzione	<i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i> <i><u>Rekomandohet</u> që institucioni të rrisë numrin e personelit akademik të kategorisë lektor, me profil në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.</i> <i>Rekomandohet të shtohet në planin mësimor lënda e Praktikës Profesionale</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UGJ e ushtron aktivitetin e tij në 3 godina. Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në Teknologji Informacioni e zhvillon procesin mësimor në Godinën A (leksione / seminare) dhe në Godinën B (laborator). Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga GVB dhe nga vizita në institucion, mjediset në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik janë të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe plotësojnë kriteret higjieno-sanitare dhe kriteret e sigurisë sipas legjislacionit në fuqi. Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024 Evid. IV.10 Infrastruktura e UGJ Evid. IV.10.1 Leje higjieno-sanitare Evid. IV.10.2 Çertifikatë për sigurinë nga zjarri

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Referuar dokumentacionit të GVB, UGJ mundëson për studentët dhe personelin akademik 23 salla për leksione dhe 43 salla për zhvillimin e seminareve. Gjithashtu përveç laboratorëve për lëndë specifike (20), në dispozicion të këtij programi studimi janë edhe 4 laboratorë të informatikës të pajisur me mjetet e nevojshme për zhvillimin optimal të mësimin. Në këtë funksion, UGJ ka investuar në përdorimin e metodologjive dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies edhe falë disa projekteve ndërkombëtare si TeComp dhe TEAVET të cilët kanë ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës mësimore si dhe në trajnimit e personelit akademik. Evid. IV.10 Infrastruktura e UGJ Evid. IV.11 Inventari i DMIF Evid. I.28 Raport projekti TeComp Evid. I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie Evid. II.34 Projekti TEAVET
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelierë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Përveç laboratorëve specifike si laboratorët e fizikës, në dispozicion të DIMF janë edhe 4 laboratorë informatike që shërbejnë për programin e studimit bachelor në "Teknologji Informatike". Numri i njësive që këta laboratorë zotërojnë (deri në 30) janë të mjaftueshëm për zhvillimin e lëndëve të profilit specifik bazuar në studentët e regjistruar në këtë program studimi. Evidenca III.2 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DMIF Evid. IV.10 Infrastruktura e UGJ Evid. IV.11 Inventari i DMIF
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në dispozicion të programit të studimit janë 4 laboratorë të teknologjisë së informacionit të pajisur me programet e nevojshme për zhvillimin e lëndëve profesionale. Pavarësisht se orët laboratorike në kurrikul janë të parashikuara vetëm 30 orë për çdo vit studimi: - Fizikë 30 orë (viti I) - Programim i Orientuar në Objekte 15 orë (viti II) - Programim II 15 orë (viti II) - Bazat e të Dhënave 30 orë (viti III)

	Këto ambiente përdoren edhe për zhvillimin e seminareve të lëndëve profesionale. Evid. IV.10 Infrastruktura e UGJ Evid. IV.11 Inventari i DMIF			
Konkluzione	<i>UGJ mundëson mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit duke përfshirë edhe 4 laboratorë informatike.</i> <i>Pavarësisht se këto laboratorë kanë pajisje të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, IAL duhet të shikojë mundësimin e investimit periodik në këto pajisje për shkak të amortizimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse propozohet nga personeli akademik përgjegjës i lëndës dhe më pas miratohet nga njësia bazë dhe njësia kryesore në përputhje me aktet rregullatore të UGJ. Literatura bazë ofrohet kryesisht me anë të teksteve fizike dhe në gjuhën shqip. Në rastet kur mungojnë tekste në gjuhën shqip, personeli akademik përgjegjës përgatit një cikël leksionesh në formatin fizik. Literatura ndihmëse për studentët ofrohet pranë librarisë së UGJ si në formë fizike ashtu edhe në mënyrë elektronike falë investimeve që UGJ ka bërë në vitin 2021 ku kjo bibliotekë është pasuruar me 893 tituj të rinj (4330 kopje fizike) me një vlerë prej 4.200.423 lek. Gjithashtu përdorimi i librarive elektronike ofron akses në mbi 1900 tituj librash të ndryshëm. Evid. II.8 Plani mësimor Bachelor në Teknologji Informatike 2018-2019 Evid. III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit

	Evid. IV.12 Miratimi i literaturës bazë në DMIF 2020-2021 Evid. IV.12.1 Miratimi i literaturës bazë në FSHN 2020-2021 Evid. IV.13 Kërkesë për blerje librash
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Miratimi i literaturës dhe i përditësimeve të saj miratohet nga njësia bazë dhe më pas nga njësia kryesore bazuar në propozimet e personelit akademik përgjegjës. Këto përditësime shoqërohen edhe me kërkesë për pasurimin e literaturës së bibliotekës në funksion të programit të studimit. Kjo kërkesë i drejtohet administratorit nga drejtuesi i njësisë bazë dhe njësisë kryesore i cili vlerëson mundësinë ekonomike të IAL në përputhje me buxhetin e miratuar në këtë drejtim. Evid. IV.12 Miratimi i literaturës bazë në DMIF 2020-2021 Evid. IV.12.1 Miratimi i literaturës bazë në FSHN 2020-2021 Evid. IV.13 Kërkesë për blerje librash
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka mësimore në dispozicion të studentëve ndodhet në godinën C. Çdo student ka të drejtën të anëtarësohet dhe të përdorë ambientet e bibliotekës për: – sallë studimi individual – akses në literaturën fizike në gjuhë shqip dhe të huaj – akses në bibliotekat online nëpërmjet kompjuterave të bibliotekës – sallë interneti Evid. III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit Evid. IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin Evid. IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit Evid. IV.14.1 Biblioteka, Manuali i përdorimit Evid. IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Përveç teksteve mësimore bazë dhe literaturës ndihmëse për studentët në formatin fizik dhe elektronik, biblioteka ofron edhe abonime në revistat shkencore: – American Mathematical Society – International Association Universities – Trading Economics Gjithashtu abonimi në Mathematical Scientific Net prej më shumë se 16 vitesh është pasqyruar si një nga pikat më të vlerësuara edhe nga personeli akademik gjatë intervistave me GVJ. Evidenca II.31 Abonim në rrjetin MathsciNet Evid. III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit

	Evid. IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin Evid. IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit Evid. IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit Evid. IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UGJ është i abonuar në bibliotekat online U-Library dhe JSTOR me një numër titujsh mbi 1900. Çdo student dhe anëtar i personelit akademik ka të drejtën për tu anëtarësuar pa asnjë pagesë dhe për të aksesuar materialet fizike, bibliotekat elektronike si dhe revistat shkencore ku UGJ është i anëtarësuar. Evid. III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit Evid. IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin Evid. IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit Evid. IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit Evid. IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Si pjesë e bibliotekës janë edhe 6 njësi kompjuterike në dispozicion të studentëve. Këto njësi kanë akses në internet dhe kanë programet kompjuterike të nevojshme për aksesimin e bibliotekave online ku UGJ është i anëtarësuar. Evid. III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit Evid. IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin Evid. IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit Evid. IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit Evid. IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Orari zyrtar i bibliotekës është nga dita e Hënë deri ditën e Premte në orarin 08:00-19:00 duke mbuluar jo vetëm orarin e zhvillimit të mësimit por edhe orare më të vona duke u mundësuar studentëve për të zgjedhur oraret e përshtatshme për përdorimin e ambjentëve të bibliotekës sipas ngarkesës së tyre mësimore. Evid. III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt	Personeli i bibliotekës raporton me kërkesë të drejtuesve të institucionit dhe njërive përbërëse të tij në lidhje me materialet dhe fondin e bibliotekës në funksion të programeve të studimit ose fushave përkatëse. Klasifikimi i fondit bibliotekar organizohet sipas rregullave UDC ku literatura në funksion të programit të studimit Bsc në "Teknologji Informacioni"

kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	klasifikohet me kodet 5. Matematikë dhe Shkencat e Natyrës dhe 6. Shkencat e Aplikuara, Mjekësia, Teknologjia. Ky klasifikim jo vetëm ndihmon përdoruesit për tu orientuar më lehtë në kërkimin e tyre për tekste specifike si dhe është pjesë e raportimit dhe lehtëson këtë proces. Evid. III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit Evid. IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin Evid. IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit Evid. IV.14.1 Biblioteka, Manuali i përdorimit Evid. IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës			
Konkluzione	<i>Programi i studimit bachelor në "Teknologji Informacioni" përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</i> <i>Ambjentet e bibliotekës janë të përshtatshme dhe me pajisjet e duhura si për studimin e literaturës fizike ashtu edhe për aksesimin online të bibliotekave elektronike.</i> <i>Investimet në vitin 2021 në pasurimin e fondit të bibliotekës kanë ndikuar pozitivisht në sasinë dhe cilësinë e shërbimit që kjo njësi ofron për studentët dhe personelin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë	Njësi përgjegjëse për administrimin e të dhënave të studentëve dhe ecurisë së tyre akademike është sekretaria mësimore e cila administron: Regjistrin themeltar të studentëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

68 / 108

informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	– Regjistrin e arritjeve akademike – Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave Për disa vite sistemi elektronik i përdorur nga UGJ ishte sistemi ESSE3. Aktualisht sistemi i përdorur nga UGJ për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe aktivitetin e tyre në mënyrë elektronike është sistemi PITAGORA i mundësuar nga RASH. Ky sistem administron rezultatet akademike të studentëve, pagesën e tarifave të studimit, proceset e vlerësimit dhe informimit të rezultateve të provimeve për studentët etj. Megjithatë, nga intervistat me studentët dhe personelin akademik u evidentua se ky sistem ka hasur në problematika të ndryshme gjatë implementimit të tij dhe për disa vite akademike nuk ka qënë funksional. Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore Evid. IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Administrimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të UGJ është përgjegjësi e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative. Kjo drejtori ndahet në 4 sektorë: – Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari-Protokollit – Sektori i Standardeve dhe Kurrikulave – Sektori i Shërbimeve Bibliotekare-Arkivore dhe Studentore – Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë Secili nga këta sektorë ruan të dhënat specifike në përputhje me rregulloren e DSHNA dhe sektorit që mbulojnë. Administrimi i dokumentacionit të aktivitetit mësimor të programit të studimit zotërohet edhe nga njësia bazë dhe njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit. Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në sistemin PITAGORA çdo përdorues (student, personel akademik ose personel ndihmës akademik) ka kredencialet përkatëse për të aksesuar sistemin dhe të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tyre mësimor. Paralel me sistemin PITAGORA, sidomos gjatë periudhës së pandemisë, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve janë mundësuar edhe platformat Office365 dhe Edumeet që ndihmojnë kryesisht në interaktivitetin në mënyrë elektronike midis personelit akademik dhe studentëve. Evid. III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeet Evid. III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Përveç përdorimit të postës elektronike, UGJ ka mundësuar edhe përdorimin e platformave Office365 dhe Microsoft TEAMS. Për secilën nga këto platforma janë hartuar manualët përkatëse për studentët dhe personelin akademik për regjistrimin në këto platforma si dhe për përdorimin optimal të funksionaliteteve të tyre. Përdorimi i këtyre platformave mund të shikohet si pozitiv pasi plotëson funksionalitetet që mungojnë në sistemin PITAGORA, por nga ana tjetër evidenton mungesën e një sistemi menaxhimi elektronik gjithëpërfshirës. Evid. III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeet Evid. III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365 Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemet e implementuara në shërbim të menaxhimit elektronik të të dhënave mundësojnë një monitorim optimal në kohë reale të aktivitetit akademik (procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit të studentëve) dhe administrativ (hartimi i dokumentacionit dhe trajtimi i pagesave të tarifave). Gjithashtu mund të krijohen raportime individuale si për ecurinë akademike të studentëve ashtu edhe për ngarkesën mësimore të personelit akademik. Evid. IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3

	Evid. III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeeet Evid. III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365 Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacioni i ofruar në faqen zyrtare elektronike të UGJ ofrohet në shqip dhe në anglisht. Në këtë faqe elektronike publikohen: - aktet rregullatore të UGJ, - të dhënat e personelit akademik të njësive bazë dhe njësive kryesore përgjegjëse për programin e studimit - kurrikula e programit të studimit bsc në "Teknologji Informacioni" - kriteret dhe kuotat e pranimi etj. https://uogj.edu.al/ https://uogj.edu.al/bursa-per-studentet/ https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimi/ https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i> <i>Sistemi kryesor i menaxhimit të të dhënave të procesit mësimor është sistemi PITAGORA i cili ka kufizime në komunikimin interaktiv midis studentëve dhe personelit akademik si dhe në disa periudha kohore nuk ka funksionuar. Për plotësimin e këtyre mangësive UGJ ka investuar në implementimin e disa platformave të tjera mbështetëse. Përdorimi i disa platformave ka qënë plotësues por identifikon problematikën e një sistemi gjithëpërfshirës.</i> <i>Rekomandohet që të punohet në mirëfunksionimin e sistemit PITAGORA, përditësimin e të dhënave që mungojnë nga periudha që ky sistem nuk ka qënë aktiv si dhe në shtimin e funksionaliteteve të reja për një raportim më cilësor dhe një interaktivitet më të lartë në komunikimin midis studentëve dhe personelit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në përfundim të çdo viti kalendarik, institucioni harton një raport financiar në nivel institucional ku pasqyrohet aktiviteti financiar i IAL. Ky raport pasqyron të ardhurat dhe shpenzimet për atë vit, krahasimin e tyre me buxhetin e miratuar dhe krijon një projeksion për të ardhurat në vitin pasardhës. Projekt buxheti për vitin pasardhës hartohet nga administratori me propozim të Senatit Akademik bazuar në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore të UGJ në përputhje me legjislacionin në fuqi për IAL-të publike. Evidenca IV.16 Propozim buxheti DMIF Evid. IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020 Evid. IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021 Evid. IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Projekt buxheti i UGJ përmban edhe parashikimin e financimit e burimeve njerëzore në nivel institucional bazuar në strukturën akademike të UGJ duke përfshirë edhe personelin e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës si njësi përgjegjëse për këtë program studimi. Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore në vitin 2022 ishte 91.7% e totalit të shpenzimeve. Shpenzimet operative propozohen nga njësia bazë gjatë hartimit të projektbuxhetit për vitin pasardhës kalendarik dhe pasqyrohen në projektbuxhetin e UGJ. Gjithashtu në projektbuxhet parashikohet çdo vit zëri për prokurim për libra për bibliotekën dhe studentët. Ky zë për buxhetin e vitit 2023 ishte parashikuar në vlerën 3.120.000 lekë. 5. ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Evidenca IV.16 Propozim buxheti DMIF Evid. IV.16.4 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025 Evid. IV.16.5 Kërkesë nga Administratori për projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026 Evid. II.14 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta Evid. II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Çdo vit UGJ harton raportimet e brendshme financiare nga Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe administratori i UGJ. Gjithashtu si IAL publike, UGJ raporton sipas legjislacionit në fuqi pranë MAS si dhe i nënshtrohet auditimit periodik nga ky institucion si dhe nga KLSH. Evid. IV.17 Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve Evid. IV.17.1 Raport i MASR AUDIT 2018 Evid. IV.17.2 Raport i MAS AUDIT 2022
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në përfundim të vitit financiar, administratori prezanton pranë Senatit Akademik raportin vjetor financiar ku pasqyrohen të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara dhe niveli i plotësimit të parashikimeve bazuar në buxhetin e miratuar për atë vit akademik. Ky raport i përcillet të gjitha njësive përbërëse të UGJ si dhe publikohet sipas kërkesave ligjore. Evid. IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020 Evid. IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021 Evid. IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësishë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në raportet e auditimit të MAS mbi veprimtarinë financiare të UGJ, sistemet e kontrollit kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi, përveç disa gjetjeve të këtij auditimi. Shpenzimet e realizuara për vitin 2022 ishin në masën 87% krahasuar me planin fillestar. Burimet e financimit kufizohen vetëm në të ardhurat nga pushteti vendor dhe tarifat e shkollimit. <i>Rekomandohet që institucioni të punojë për të gjetur alternativa të tjera për të gjeneruar të ardhura për të përmirësuar situatën financiare.</i> Evid. IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020 Evid. IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021 Evid. IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022 Evid. IV.17 Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve Evid. IV.17.1 Raport i MASR AUDIT 2018 Evid. IV.17.2 Raport i MAS AUDIT 2022
Konkluzione	<i>UGJ ka të ngritura sistemet e auditimit të aktivitetit financiar të cilat funksionojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga auditimet periodike të MAS dhe KLSH janë evidentuar disa mangësi dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e aktivitetit financiar.</i>

	<i>Një nga mangësitë e evidentuara nga GVJ është mungesa e diversifikimit të burimit të të ardhurave të institucionit. Për vitin 2023 këto të ardhura ishin vetëm nga pushteti vendor dhe tarifat e shkollimit të studentëve. Duke konsideruar se burimet nga pushteti vendor synojnë kryesisht mbulimin e pagave dhe sigurimeve të personelit të UGJ (91.7% e shpenzimeve) si dhe trendin e zvogëlimit të numrit të studentëve rekomandohet që UGJ të punojë për të gjetur alternativa të tjera për të gjeneruar të ardhura për të përmirësuar situatën financiare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë të pasqyruara në statutin dhe aktet rregullatore të UGJ si dhe në rregulloren e programit të studimit bachelor në “Teknologji Informacioni”. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për	Aktet rregullatore të UGJ përmbajnë të gjitha procedurat e pranimin, të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë kohëzgjatjes së tyre të studimit si dhe procedurat e diplomimit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

74 / 108

studentë dhe studentët e programit të studimit.	Këto akte rregullatore janë publike dhe garantojnë barazinë dhe procedura të njëjta për të gjithë studentët e këtij programi studimi. Evid. I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e pranimit për programin e studimit bachelor në Teknologji Informacioni janë: – 50% mesatare e VKM – 25% gruplëndët Matematikë – 25% gruplëndët TIK Këto kritere propozohen çdo vit akademik nga njësia bazë dhe miratohen nga Senati Akademik i UGJ. Kuotat dhe kriteret i dërgohen MAS dhe pasqyrohen në sistemin U-Albania bazuar në legjislacionit në fuqi. Për këtë program studimi nuk parashikohen kuota për studentë të huaj por janë parashikuar 3 kuota për studentët e trojeve. Evid. V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024 Evid. II.13.4 Vendim Senati Akademik për kuotat 2022-2023 dhe kriteret 2023-2024 https://uogj.edu.al/ https://uogj.edu.al/bursa-per-studentet/ https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/ https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procedurat e aplikimit, kriteret dhe procedurat e pranimit publikohen për të gjithë aplikantët e interesuar për tu regjistruar në këtë program studimi. Vlerësimi i studentëve është i ndarë në dy pjesë: – vlerësimi i vazhdueshëm (deri në 20%) – vlerësimi përfundimtar (jo më pak se 80%) Bazuar në rregulloren e programit të studimit bachelor në Teknologji Informacioni njohja e krediteve bëhet vetëm nëse programi i lëndës ka të paktën 80% ngjashmëri. Sugjerohet që kjo vlerë të zvogëlohet në të paktën 70%. Të gjitha këto procedura janë pjesë e akteve të brendshme rregullatore të cilat janë të publikuara në faqen elektronike zyrtare të UGJ. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni.

	Evid. II.20 Procedurë e transferimit të studentëve https://uogj.edu.al/ https://uogj.edu.al/bursa-per-studentet/ https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/ https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Mënyra e informimit të publikut në lidhje me kërkesat dhe kriteret e pranimit të programit të studimit bachelor në Teknologji Informacioni realizohet duke përdorur faqen zyrtare elektronike të UGJ si dhe rrjetet sociale të UGJ. Gjithashtu promovimi i programeve të studimit bëhet edhe nëpërmjet panairove Work and Study të organizuara nga MAS ku mundësohet komunikimi i IAL-ve me kandidatët për student dhe maurantët e interesuar për programet e studimit. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. V.14 Udhërrëfyesi i studentëve Evid. II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022 Evid. II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Për vitin akademik 2023-2024, UGJ ka miratuar për programet e studimit të ciklit të parë: – 6 kuota për studentë të huaj (0.38%) – 23 kuota për statusin e jetimit (1.45%) – 31 kuota për persona me aftësi të kufizuar (1.95%) – 20 kuota për romë + ballkano egjiptian (1.26%) – 127 kuota për trojet (7.99%) Për programin e studimit bachelor në Teknologji Informacioni janë miratuar vetëm 3 kuota për trojet dhe nuk janë parashikuar kuota të veçanta për kandidatët nga shtresat e marginalizuara, pakicat ose kandidatët me aftësi të veçanta. <i>Sugjerohet që në planifikimin e kuotave në të ardhmen të parashikohen kuota të veçanta edhe për këtë program studimi.</i> Evid. V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024 Evid. V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024 Evid. V.2.2 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025 Evid. II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020 Evid. II.14.3 Vendim Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë

	Evid. II.14.4 Vendim Senati Akademik për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë Evid. II.14.5 Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë https://uogj.edu.al/ https://uogj.edu.al/bursa-per-studentet/ https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimi/ https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Programi i studimit bachelor në Teknologji Informacioni në kuotat e pranimi të miratuara për vitin akademik 2023-2024 ka planifikuar 3 kuota të veçanta për kandidatët nga trojet. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e tyre bazohen në udhëzimet e MAS që publikohen përpara fillimit të çdo viti akademik. Evid. V.2 Kuotat e pranimi viti akademik 2023 - 2024 Evid. V.2.1 Kriteret e pranimi për vitin akademik 2023-2024 Evid. V.2.2 Kriteret e pranimi për vitin akademik 2024-2025 https://uogj.edu.al/ https://uogj.edu.al/bursa-per-studentet/ https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimi/ https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës / bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Përveç bursave dhe përjashtimit nga pagesa e tarifës për kategoritë e veçanta që përcaktohen nga politikat dhe vendimet e MAS dhe Këshillit të Ministrave, UGJ ka miratuar edhe përjashtimin e studentëve nga detyrimi i pagesës së tarifës vjetore për programet e ciklit të parë të fushës së mësuesisë si programe me përparësi dhe prioritet kombëtar. Evid. II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020 Evid. II.14.3 Vendim Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë Evid. II.14.4 Vendim Senati Akademik për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë Evid. II.14.5 Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë
Konkluzione	<i>UGJ ka të pasqyruara qartë në aktet e brendshme rregullatore politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i> <i>UGJ në politikat që ndjek miraton me propozim të njëjësive bazë edhe kuotat për çdo program studimi duke parashikuar edhe kuota të veçanta për kategori të veçanta. Megjithatë, për</i>

	<i>programin e studimit bachelor në Teknologji Informacioni nuk janë parashikuar kuota të veçanta për kategoritë:</i> – <i>studentë të huaj</i> – <i>me statusin e jetimit</i> – <i>persona me aftësi të kufizuar</i> – <i>romë + ballkano egjiptian</i> <i>Sugjerohet që në planifikimin e kuotave në të ardhmen të parashikohen kuota të veçanta edhe për këtë program studimi</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentët informohen çdo fillim viti akademik në lidhje me procesin mësimor si dhe informohen nga personeli akademik i lëndës në lidhje me detyrimet përkatëse, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, programin e lëndës etj. Që studenti të kalojë në vitin pasardhës akademik, ai duhet të ketë siguruar të paktën 30 kredite nga viti që është duke frekuentuar. Nëse nuk siguron kreditet e kërkuara ai konsiderohet si student përsëritës. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evid. I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. V.14 Udhërrëfyesi i studentëve
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët e interesuar për të transferuar kreditet nga kualifikime apo studime të pjesshme të mëparshme informohen në mënyrë të detajuar nga njësia bazë dhe sekretaria mësimore sidomos gjatë shpalljes së aplikimeve për transferimin e studimeve para fillimit të vitit akademik. Procedurat e njohjes dhe transferimit të krediteve bëhen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga njësia bazë në përputhje të statutit dhe rregulloreve të brendshme të UGJ në rastet e aplikantëve për transferim

	studimi por edhe në rastet e mobilitetit të studentëve si pjesë e marrëveshjeve Erasmus+. Evid. I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evidenca V.5.1 Njohje e krediteve nga mobilitetet Erasmus+. Evid. V.14 Udhërrëfyti i studentëve
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Informacioni për procedurat dhe kriteret e vlerësimit të dijeve gjatë kohëzgjatjes së periudhës së studimit është i pasqyruar në rregulloret e brendshme të IAL dhe është lehtësisht i aksesueshëm për studentët. Gjithashtu në fillim të çdo semestri personeli akademik përgjegjës për kurset specifike informon studentët në lidhje me mënyrën e vlerësimit të kursit përkatës. <i>Megjithatë ky informacion nuk është i plotë në disa raste ose ka mospërputhje midis mënyrës si është pasqyruar në rregullore krahasuar me pasqyrimin në programet lëndore.</i> Përcaktohet se vlerësimi i studentëve bëhet me notë nga 1 në 10 (nota më e ulët është 4) dhe se nota më e ulët kaluese është nota 5. Mënyra e pikësimit përcaktohet vetëm në rregulloren e UGJ dhe nuk pasqyrohet në rregulloren e programit të studimit, rregulloren e studimeve apo në programet lëndore. Në rregulloret e institucionit frekuentimi i leksioneve është kryesisht fakultativ ndërkohë ndjekja e elementëve të tjerë të mësimi (seminare, laboratorë) duhet të jetë në një masë jo më pak se 80%. Ndërkohë në programet lëndore niveli i frekuentimit të seminareve është pasqyruar në 75% të orëve të zhvilluara. Vlerësimi për lëndët realizohet deri në 20% si vlerësim i vazhdueshëm dhe jo më pas se 80% si pjesë e vlerësimit përfundimtar. Megjithatë në programet lëndore nuk është e përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit të vazhdueshëm. Gjithashtu procedurat e vlerësimit në një pjesë të rregulloreve përfshijnë përdorimin e sistemit ESSE3 i cili nuk është më funksional. <u>Sugjerohet që:</u> <i>1. Programet lëndore të pasqyrojnë në mënyrë korrekte masën e frekuentimit të studentëve për seminarët dhe elementet e tjera</i>

	me frekuentim të detyrueshëm në përputhje me rregulloret e institucionit. 2. Të pasqyrohet qartë në programet lëndore mënyra e vlerësimit të vazhdueshëm për studentët. 3. Rregullorja e programit të studimit dhe programet lëndore të pasqyrojnë pikët e nevojshme që studenti duhet të përfitojë për kalimin nga njëra notë në tjetrën. 4. Të rregullohet në rregulloret e institucionit informacioni në lidhje me sistemin funksional ku pasqyrohen arritjet akademike të studentëve (ESSE3) si dhe shkalla e vlerësimit (nga 4 në 10) Evid. I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22 Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloret e brendshme është përcaktuar që niveli i mesatares që i mundëson studentit për të përgatitur temë / punim diplome është të paktën 8. Studentët që nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare diplomohen me provim të përgjithshëm diplome. Në fillim të çdo viti akademik, njësia bazë përgjegjëse vendos në dispozicion të studentëve që do zhvillojnë temë diplome fushat e studimit dhe miratojnë personelin akademik udhëheqës për secilin student. Gjithashtu për studentët që do zhvillojnë provim përfundimtar diplome vendoset në dispozicion një listë me pyetje informuese. Evid. III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.11.1. Miratimi i fushave të studimit Evid. III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon	Promovimi i programit të studimit është një praktikë që zhvillohet çdo vit para fillimit të vitit akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në panairët Work and Study të organizuara nga MAS për këtë qëllim. Për këto aktivitete UGJ organizon

takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	fletëpalosje dhe materiale të tjera promovuese për informimin e personave të interesuar për të ndjekur këtë program studimi. Evid. II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022 Evid. II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023 Evid. V.13.2 Plani vjetor i punës Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës Evid. V.14 Udhërrëfyesi i studentëve			
Konkluzione	<i>UGJ pasqyron në rregulloret e brendshme informacion të plotë mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit bachelor në Teknologji Informacioni.</i> <i>Megjithatë përsa i përket mënyrës së vlerësimit dhe detyrimit të frekuentimit të lëndëve përkatëse ky informacion nuk është i pasqyruar në rregulloren e programit të studimit ose programet lëndore dhe në disa raste është jo i plotë. Për këtë arsye sugjerohet që:</i> <i>1. Programet lëndore të pasqyrojnë në mënyrë korrekte masën e frekuentimit të studentëve për seminarët dhe elementet e tjera me frekuentim të detyrueshëm në përputhje me rregulloret e institucionit.</i> <i>2. Të pasqyrohet qartë në programet lëndore mënyra e vlerësimit të vazhdueshëm për studentët.</i> <i>3. Rregullorja e programit të studimit dhe programet lëndore të pasqyrojnë pikët e nevojshme që studenti duhet të përftojë për kalimin nga njëra notë në tjetrën.</i> <i>4. Të rregullohet në rregulloret e institucionit informacioni në lidhje me sistemin funksional ku pasqyrohen arritjet akademike të studentëve (ESSE3) si dhe shkalla e vlerësimit (nga 4 në 10).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të	Informacioni për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit është i pasqyruar qartë në rregulloret e

hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	brendshme të institucionit dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga ana e studentëve. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet qartë që për tu diplomuar studenti duhet të përftojë 180 kredite në një kohëzgjatje jo më pak se 3 vite akademike. Gjithashtu pasqyrohet edhe mënyra e organizimit të vitit akademik, semestrave etj. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Informacioni në lidhje me lëndët dhe përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese pasqyrohet në planin mësimor të programit të studimit bachelor në Teknologji Informacioni që është pjesë e rregullores së programit të studimit si dhe në programet lëndore të cilat personeli akademik përgjegjës ua mundëson studentëve çdo fillim semestri për lëndët që studentët duhet të frekuentojnë. Ky informacion është i disponueshëm edhe në faqen elektronike zyrtare të UGJ. Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. II.28 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 22-23 Evid. II.28.1 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 21-22 Evid. II.28.2 Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në TI 20-21 Evid. III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Teknologji Informacioni Evid. III.11.1. Miratimi i fushave të studimit Evid. III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Informimit të studentëve në lidhje me mundësitë e punësimit realizohet nga njësia bazë në bashkëpunim me Zyrën e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar. Mënyra e informimit të studentëve është kryesisht me anë të panairëve të punës por edhe duke shpërndarë mundësitë e punës apo praktikave profesionale që mundësohen nga



	institucionet dhe bizneset partnere me të cilat UGJ ka marrëveshje. Evid. V.13 Formular kontakti Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës-Student Evid. V.13.1 Korrespondenca- Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës Evid. V.13.2 Plani vjetor i punës Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni për studentët në lidhje me organizimin e procesit mësimor mundësohet me anë të komunikimit të drejtpërdrejtë të studentëve me njësinë bazë, me anë të njoftimeve të publikuara pranë sekretarisë mësimore si dhe me anë të komunikimit më këtë njësi, si dhe me mënyra të komunikimit elektronik me anë të publikimit të informacionit në faqet zyrtare të UGJ, postës elektronike apo me anë të sistemit të brendshëm të UGJ. Nga komunikimi me studentët u konstatua që kjo mënyrë komunikimi është funksionale dhe praktike. Evid. 9 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorise së Shërbimeve Ndihmes Akademike – Administrative Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm aktual që UGJ përdor është sistemi PITAGORA. Nga komunikimi me studentët dhe personelin akademik ky sistem ka pasur probleme në periudha të caktuara gjatë implementimit të tij por aktualisht është funksional. Në periudhat kur sistemi ka pasur probleme, komunikimi është plotësuar me anë të postës elektronike dhe publikimit të informacionit në faqen elektronike zyrtare të UGJ. Gjithsesi në rregulloret e brendshme akoma shfaqet sistemi ESSE3 dhe jo sistemi Pitagora. <i>Sugjerohet që të punohet në saktësimin e sistemit të menaxhimit që do jetë funksional në të ardhmen në UGJ, implementimin e tij në përputhje me kërkesat dhe aktet e brendshme rregullatore të UGJ si dhe pasqyrimin në këto rregullore të rolit që ky sistem do ketë (funksionalitetet).</i> Evid. IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3 https://uogj.edu.al/
Konkluzione	<i>UGJ vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin,</i>

	<i>përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i> <i>Megjithatë duhet të punohet në përmirësimin dhe implementimin me funksione të plota të sistemit të brendshëm të menaxhimit dhe përditësimin e rregulloreve të brendshme për të pasqyruar funksionalitetet e këtij sistemi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Të dhënat e studentëve të diplomuar mirëmbahen nga sekretaria mësimore si dhe administrohen nga njësi bazë. Këto të dhëna përditësohen në fund të çdo viti akademik në shërbim të autoriteteve dhe organeve drejtuese kur këto të fundit e kërkojnë si informacion si dhe në shërbim të hartimit të raporteve vjetore të UGJ dhe njësive të saj. Sipas të dhënave të GVB, në programin e studimit bachelor në Teknologji Informacioni janë diplomuar në 3 vitet e fundit akademike 28 studentë, përkatësisht: – 13 studentë në vitin akademik 2020-2021; – 6 studentë në vitin akademik 2021-2022; – 9 studentë në vitin akademik 2022-2023; Evid. I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 Evid. II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore Evid. V.6 Raport statistikor student-pedagog për çdo fakultet
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para	Njësi bazë dhe sekretaria mësimore ruan të dhëna dhe statistika për studentët e regjistruar në këtë program studimi si dhe për ecurinë e tyre akademike deri në përfundimin ose ndërprerjen e studimeve të tyre. Në 3 vitet e fundit akademike në këtë program studimi janë regjistruar 54 studentë, 6 prej të cilëve kanë transferuar studimet në këtë program studimi. Përkatësisht:

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

84 / 108

përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	– 13 studente (3 të transferuar) në vitin akademik 2020-2021 – 19 studentë në vitin akademik 2021-2022 – 22 studentë (3 të transferuar) në vitin akademik 2022-2023 Këto statistika u verifikuan nga GVJ edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të FSHN. Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore Evid. II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga sekretaria mësimore si në formatin fizik (regjistrat themeltar dhe të arritjeve akademike) ashtu edhe në formatin elektronik. Kjo njësi është përgjegjëse për sigurinë e këtyre të dhënave dhe për ruajtjen e konfidencialitetit. Autoritetet dhe organet drejtuese mund të kenë akses në këto të dhëna si dhe mund të kryejnë kontrole për saktësinë e tyre. Gjithashtu drejtuesit e njësisë bazë / kryesore mund të kenë akses në këto të dhëna edhe nëpërmjet sistemit Pitagora. Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore Evid. II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit Evid. IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në aktet e brendshme rregullatore të UGJ, çdo autoritet ose organ drejtues ka detyrë të monitorojë zbatimin me korrektësi të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi si dhe saktësinë e të dhënave që UGJ administron. Përveç raportimeve periodike që sekretaria mësimore kryen, ajo mund të jetë edhe objekt auditimi me iniciativë të autoriteteve ose organeve drejtuese të njësisë bazë / kryesore ose të UGJ. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore të dhënat për ecurinë akademike të disa studentëve të këtij programi studimi, numrin e studentëve të regjistruar, pajisjen me numër matrikullimi etj. Nga verifikimet e kryera të dhënat e ruajtura nga sekretaria mësimore ishin në përputhje me procesverbalet e notave si dhe me statistikat e deklaruara nga GVB. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës

	Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore Evid. VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UGJ harton në përfundim të çdo viti akademik raportin e aktivitetit vjetor përfshirë edhe aktivitetin akademik. Ky raport mbështetet kryesisht në raportimet e njësive bazë. Në mënyrë më të detajuar këto të dhëna pasqyrohen në raportin vjetor të Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Megjithatë në RVB dhe dokumentacionin mbështetës, në raportimin e njësisë bazë mungon informacioni për një pjesë të të dhënave analitike për këtë program studimi. 5. RVB - Aneks-tabelat përmbledhëse Evidenca I.12.4 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2021-2022 Evidenca VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021			
Konkluzione	<i>UGJ mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i> <i>Megjithatë sugjerohet që në raportet e njësisë bazë informacioni në lidhje me studentët të jetë më i detajuar duke përfshirë edhe cilësinë në hyrje dhe në dalje për çdo program studimi apo dhe statistika të tjera.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	Institucioni parashikon në aktet e brendshme rregullatore përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse bazuar në legjislacionin në fuqi. Përveç përfaqësimit në Senatin Akademik (në masën 10%), studentët janë të organizuar në Këshillin Studentor të UGJ si organ koordinues kryesor për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e studentëve në vendimmarrje.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

86 / 108

këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Pjesë e Këshillit Studentor është edhe Senati Studentor me një strukturë prej 19 anëtarësh. Gjithashtu studentët përfaqësohen edhe në NJSBC dhe janë pjesë e grupeve të punës për hartimin e RVB gjatë procesit të akreditimit të programit të studimit. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. II.24 Statuti i Këshillit Studentor Evid. II.25 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Pjesëmarrja e studentëve me përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, NJSBC dhe organizimi i Këshillit Studentor i mundëson atyre të jenë pjesë e vendimmarrjes dhe vlerësimit të procesit akademik. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. II.24 Statuti i Këshillit Studentor Evid. II.25 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Në UGJ studentët japin sugjerimet e tyre në lidhje me cilësinë e programit të studimit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese. Megjithatë mungon një procedurë e rregullt periodike për vlerësimin e opinionit të studentëve në lidhje me përmirësimin e programit të studimit. <i>Sugjerohet që IAL të hartojë anketime periodike për studentët për të identifikuar problematika të mundshme dhe mundësi për përmirësimin e programit të studimit dhe procesit mësimor.</i> Evid. II.24 Statuti i Këshillit Studentor Evid. II.25 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor Evid. III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit Evid. III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore Evid. VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022 Evid. VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021 Evid. VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë	Në rastet kur studentët kanë pretendime për mënyrën e vlerësimit ose për procesin e zhvillimit të testimeve atëherë ata kanë të drejtë të bëjnë një kërkesë me shkrim drejtuar dekanit

dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	të njësisë kryesore. Në rastet kur vlerësohet se kërkesa është e arsyetuar, brenda dy ditëve merret vendim për ndryshimin e komisionit dhe rizhvillimin e provimit. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni			
Konkluzione	<i>UGJ ka parashikuar në rregulloret e brendshme përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese me anë të përfaqësuesve të tyre të zgjedhur.</i> <i>Megjithatë mungon një mënyrë vlerësimi periodike apo anketimi në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj studentëve.</i> <i><u>Sugjerohet</u> që institucioni / njësia bazë të hartojë dhe shpërndajë në mënyrë periodike anketime për studentët në lidhje me vlerësimin e tyre për cilësinë e procesit mësimor dhe programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore	Njësitë kryesore në shërbim të informimit të studentëve të programit të studimit bachelor në “Teknologji Informacioni” është njësia bazë DMIF dhe sekretaria mësimore e FSHN. Krahas strukturave të njësisë bazë dhe njësisë kryesore, në shërbim të informimit të studentëve në nivel institucional janë edhe:



dhe aktet rregullatore të institucionit.	- Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrative - Sektori i Shërbimeve Biblotekare Arkivore dhe Studentore - Zyra Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar - Zyra e IT - Drejtoria e Shërbimeve Universitare - Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë Evid. I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër Evid. II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022 Evid. II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	DMIF dhe sekretaria mësimore e FSHN janë njësitë kryesore përgjegjëse për informimin dhe këshillimin e studentëve të programit të studimit bachelor në "Teknologji Informacioni" për çështjet e procesit mësimor dhe programit të studimit. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve është edhe përdorimi i sistemit Pitagora, publikimi i informacioneve kryesore në faqen zyrtare elektronike dhe rrjetet sociale të UGJ si dhe komunikimi nëpërmjet postës elektronike. Evid. I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër Evid. I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe	Njësia kryesore, në bashkëpunim me njësinë bazë, në shërbim të studentëve për këshillimin e karrierës dhe zhvillimin e praktikave profesionale është Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar. Kjo zyrë harton një plan vjetor aktiviteteve në funksion të informimit të studentëve në lidhje me: - Shkëmbimin e eksperiencave me Alumni - Trajnime dhe aktivitete ekstrakurrikulare - Mundësitë e studimit në ciklin e dytë të studimeve - Mundësi për punësime dhe zhvillimin e praktikës profesionale - Takime të hapura me personalitete të fushave përkatëse etj.

orientimin në tregun e punës.	Evid. II.18 Databazë Alumni Evid. II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni Evid. V.13 Formular kontakti Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës-Student Evid. V.13.1 Korrespondenca- Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës Evid. V.13.2 Plani vjetor i punës Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në mënyrë periodike, Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar grumbullon me anë të një formulari kontakti të dhënat në lidhje me studentët e diplomuar. Në përfundim të çdo viti akademik këto të dhëna përpunohen dhe u vihen në dispozicion organeve dhe autoriteteve drejtuese për të gjurmuar ecurinë e programeve të studimit në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Megjithatë, kjo njësi, has vështirësi në gjurmimin apo përgjigjet e ish-studentëve të diplomuar pran UGJ. Edhe pse kjo njësi ka një bazë të dhënash me ish-studentët, dhe i kontakton në mënyrë periodike ose nëpërmjet postës elektronike ose nëpërmjet telefonit, por vetë një numër i vogël përgjigjen. Evid. II.18 Databazë Alumni Evid. II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni Evid. V.13 Formular kontakti Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës-Student Evid. V.13.1 Korrespondenca- Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës Evid. V.13.2 Plani vjetor i punës Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës			
Konkluzione	<i>Universiteti i Gjirokastrës, për programin e studimit në Teknologji Informacioni, informimi kryesor për studentët vjen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe nga sekretaria mësimore.</i> <i>Edhe pse në tërësi ka të ngritur zyra dhe organizim të brendshëm për pritjen dhe orientimin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

90 / 108

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UGJ ka hartuar një “Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies” në ndihmë të personelit akademik dhe studentëve për prezantimin me metodat e reja të mësimdhënies. Në këtë funksion, gjatë periudhës së pandemisë janë hartuar edhe udhëzues dhe manuale specifike për implementimin e teknologjive në dispozicion të zhvillimit të mësimi online. Evid. III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies Evid. III.5.4 Vendim SA për miratimin e udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Në përfundim të çdo viti akademik, strukturat përgjegjëse për monitorimin e procesit mësimor si dhe të aktivitetit të personelit akademik hartojnë raportet përkatëse. Këto raporte hartohen në nivel grupi mësimor, në nivel njësie bazë si dhe në nivel institucional. Sektori përgjegjës në nivel institucional për monitorimin dhe raportimin e cilësisë në mësimdhënie të personelit akademik është Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <i>Megjithatë në këto raporte mungon pasqyrimi i opinionit të studentëve në këtë drejtim.</i> Evid. II.27 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AMzF Evid. II.27.1 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AGJl Evid. VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022 Evid. VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021



	Evid. VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Bazuar në rregulloret e brendshme të UGJ, studentët kanë të drejtë të ankimojnë rezultatet e vlerësimit të tyre në rast se pretendojnë për parregullsi në procesin e vlerësimit ose në rastet kur nuk janë të bindur me rezultatin e përfutur. Këto kërkesa i drejtohen dekanit të FSHN i cili në rastet kur e shikon të arsyeshme bën miratimin e kërkesës dhe ngre një komision të ri vlerësimi për përsëritjen e provimit. <i>Përsa i përket vlerësimit periodik të formave të mësimdhënies, përfshirja e studentëve është e kufizuar në raste specifike si në rastin e zhvillimit të mësimdhënies online.</i> Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. II.24 Statuti i Këshillit Studentor Evid. II.25 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor Evid. III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit Evid. III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore Evid. VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022 Evid. VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021 Evid. VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia përgjegjëse për monitorimin dhe hartimin e raporteve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies është Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Kjo strukturë në bashkëpunim me njësitë bazë përpunon dhe publikon rezultatet e vlerësimit në raportet vjetore që hartohen çdo fund viti akademik. Evid. VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022 Evid. VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021 Evid. VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon	Në raportet vjetore të hartuara nga SSCK evidentohen jo vetëm problematikat por edhe pikat e forta duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në këtë funksion është punuar në përmirësimin

shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	e shpërndarjes së ngarkesës mësimore për personelin akademik, përmirësimin e infrastrukturës mësimore si dhe në përfshirjen e stafit në projekte për metodologjitë e mësimdhënies ose si pjesë e shkëmbimeve të personelit akademik të FSHN në IAL partnere perëndimore. Evid. I.29 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik DMIF për vitin akademik 20-21, 21-22, 22-23 Evid. III.15.4 Listë me 3personat që kanë dhënë mësim ose kanë bërë punë kerkimore në një universitet perëndimor			
Konkluzione	<i>UGJ ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Njësia kryesore përgjegjëse për këtë proces është Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave që në bashkëpunim me njësitet bazë harton raporte vjetore periodike për të identifikuar problematikat dhe duke sugjeruar zgjidhjet përkatëse.</i> <i>Megjithëse në statutin e UGJ parashikohet se një nga të drejtat e studentëve është të shprehin vlerësimin e tyre për mësimdhënien dhe punën e personelit në UGJ, kjo e drejtë aplikohet vetëm me shprehjen e opinionit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese ose në rastet e propozimeve nga ana e Këshillit Studentor.</i> <i>Rekomandohet që institucioni të hartojë një anketim periodik drejtuar studentëve në lidhje me opinionin e tyre për cilësinë e procesit mësimor si dhe për punën e personelit të UGJ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë	Në funksion të hartimit të politikave dhe procedurave për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, si pjesë e UGJ është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo strukturë funksionon në bashkëpunim të ngushtë me njësitet bazë / kryesore bazuar në statutin e UGJ dhe rregulloren e brendshme

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

93 / 108

(SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	të NJSBC. Një tjetër strukturë në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është edhe Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Evid. I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC Evid. VI.8.1 Vendim Senati për miratimin e NJSBC në UGJ
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	NJSBC, SSKC dhe njësitë bazë / kryesore, në përputhje me planin strategjik të UGJ zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre si pjesë e NJSBC si dhe në GVB për vlerësimet e programeve të studimit si pjesë aktive për SBC. Palët të treta si biznese apo institucione të tjera partnere bashkëpunojnë me UGJ bazuar në marrëveshje dypalëshe. Megjithatë, kjo njësi ndjek proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë për raportimin e gjetjeve apo proceseve që kanë nevojë të përmirësohen, dhe i parashtrohet ato për organet drejtuese. Kjo njësi nuk ndjek dhe nuk ka mekanizma të ndjekjes së veprimeve përmirësuese që mund të lindin nga aktet vendimarrëse të autriteteve drejtuese. Evid. I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë 2020-2025 Evid. I.6 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.8 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC Evid. VI.8.1 Vendim Senati për miratimin e NJSBC në UGJ
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, është një institucion publik i arsimit të lartë, i licencuar në bazë të VKM nr. 4, datë 08.I.1971 me statusin si “Institut Pedagogjik” dhe me Vendimin Nr. 124, datë 01.04.1989, i është vendosur emri “Eqrem Çabej”. UGJ është akredituar institucionalisht në 16.12.2021 me vendimin nr. 55, të Bordit të Akreditimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me kohëzgjatje prej 4 (katër) vite akademike, deri më 15.12.2025. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Ky program studimi është hapur sipas VKM Nr. 516, datë 30.06.2010 për “Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në Universitetin

	“Eqrem Çabej”, Gjirokastrë”. Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit e këtij programi studimi po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të UGJ drejtuar ASCAL-it, më datë 15.12.2022, Nr. 1685 Prot. dhe protokolluar në ASCAL me Nr. 421 Prot, datë 19.12.2022. Evid. I.10 Riorganizimi i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës Evid. II.7 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019 Evid. II.9 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Në raportet periodike të DMIF dhe NJSBC pasqyrohen në mënyrë analitike rezultatet dhe gjetjet në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin e personelit akademik për atë vit akademik. Bazuar në treguesit cilësor të përcaktuar në bazën ligjore dhe standardet e cilësisë, propozohen dhe masat përkatëse për përmirësimin e këtyre treguesve. Por këto masa të propozuara nuk shoqërohen me afate kohore për realizimin e tyre apo edhe me kriteret matëse sasiore të realizimit të masave korrigjuese të propozuara. Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC			
Konkluzione	<i>Universiteti i Gjirokastrës ka të ngritur njësisë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, njësi që kryesisht kufizohet në raportimin e gjendjes aktuale institucionale në përputhje me standardet e cilësisë në nivel institucional, ashtu edhe për programet e studimit.</i> <i>Kjo njësi, nuk ka mekanizma apo rol në ndjekjen e proceseve që pasojnë vendimmarrjen e autoriteteve drejtuese në lidhje me përmirësimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

95 / 108

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në mënyrë periodike, DMIF ka propozuar dhe ka miratuar ndryshime në pranin mësimor të programit të studimit bachelor në “Teknologji Informatike” në funksion të përshtatjes së këtij programi studimi me ndryshimet e kërkesave ligjore (2018-2019) ose në funksion të gjetjeve dhe përshtatjes me kërkesat e kohës (2021-2022). Pjesë e këtyre përmirësimeve është edhe përditësimi i literaturës dhe programeve lëndore për kurset e këtij programi studimi. Institucioni ka të ngritur mekanizmat administrative për vlerësimin e cilësisë, por ato jo gjithmonë rezultojnë të mjaftueshme apo të tilla që të garantojnë përmirësimin në vazhdim të ofertës didaktike. Departamenti organizon raporte të brendshme periodike, raporte të cilat duhet të venë në dukje nevojat për përmirësim, si dhe të përcaktojnë edhe mënyrat e arritjes së këtyre objektivave. Gjë që realizht nuk ndodh. Evid. II.6 Vendim Senati për miratimin e suplementit Evid. II.6.1 Model suplementi i diplomës Evid. II.6.2 Udhëzim Nr. 11, dt. 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR Evid. II.7 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019 Evid. II.7.1 Dërgim në MASR të riorganizimit të planeve mësimore Evid. II.8.1 Vendim miratimi plane mësimore DMIF Evid. II.9 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022 Evid. II.9.1 Plan mësimor Bachelor në TI 2021-2022 Evid. II.22 Miratimi i literaturës bazë në DMIF 2020-2021 Evid. II.22.1 Miratimi i literaturës bazë në FSHN 2020-2021 Evid. II.27 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AMzF Evid. II.27.1 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AGJl
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe	Raportet vjetore të grupeve mësimore, të DMIF dhe SSCK pasqyrojnë gjetjet përkatëse së bashku me masat e mara dhe masat e propozuara për përmirësimin e problematikave të gjetura në raportet përkatëse. Megjithatë në shumicën e rasteve këto raporte përmbajnë një listë gjetjesh dhe problematikash si dhe sugjerime të përgjithshme në lidhje me përmirësimin e këtyre problematikave pa propozuar një plan masash që duhen ndërmarrë përgjatë vitit të ardhshëm akademik.

përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	<u><i>Sugjerohet që gjetjet e raporteve të plotësohen me një plan masash me afate të caktuara qartë dhe një metodologji zbatimi të këtij plani.</i></u> Evid. II.27 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AMzF Evid. II.27.1 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AGjI Evid. IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin Evid. V.6 Raport statistikor student-pedagog për çdo fakultet Evid. VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022 Evid. VI.6.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021 Evid. VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Programi i studimit bachelor në “Teknologji Informacioni” nuk është pjesë e profesioneve të rregulluara. Në kuadër të mbarëvajtjes së këtij programi studimi, DMIF monitoron dhe raporton raporte statistikore për të përmbushur kërkesat ligjore dhe ato të standardeve të cilësisë ku përfshihet ngarkesa mësimore e personelit akademik, raportet studentë / personel akademik, raporti i ngarkesës mësimore për PAE dhe PAK, ecuria e numrit të studentëve të regjistruar në programin e studimit, kalueshmëria dhe cilësia e tyre në hyrje etj. Evid. III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit Evid. III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e	Në raste specifike ose me kërkesë të njësisë bazë, UGJ përdor edhe anketimin e studentëve si një metodë vlerësimi për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Pjesë e këtyre anketimeve mund të përmendet pyetësori për mësimdhënien online gjatë periudhës së pandemisë, pyetësorët e organizuar për studentët e diplomuar, sondazhi kombëtar i studentëve etj.

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

97 / 108

intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<i>Megjithatë sugjerohet që anketimi për opinionin e studentëve për cilësinë e mësimdhënies të jetë më i strukturuar dhe i detyrueshëm për tu zhvilluar në mënyrë periodike çdo vit akademik.</i> Evid. III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit Evid. III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete			
Konkluzione	<i>Universiteti i Gjirokastrës ka të mirë organizuar procedurat e brendshme për raportimin e gjetjeve dhe propozimeve për përmirësime të mëtejshme në tërësi të të gjithë ofertës didaktike dhe shërbimeve që ky institucion ofron.</i> <i>Këto njësi apo mekanizma, në pjesën më kryesore të tyre, bazohen në raportimet e gjendjes aktuale dhe nevojave për përmirësime, pa përcaktuar mekanizma përmirësimi apo dhe ndjekje të veprimeve për përmirësim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe	Njësitë përgjegjëse për Sigurinë e Brendshme të Cilësisë kanë në përbajtje të tyre personel akademik, personel administrativ si dhe përfaqësues të studentëve. Statuti i UGJ dhe rregulloret e brendshme të institucionit parashikojnë në rast nevojë edhe angazhimin nga ana e SSCK ose e GVB e ekspertëve të jashtëm për konsulencë për çështje specifike. Pavarësisht se përfshirja e aktorëve të jashtëm në sigurimin e brendshëm të cilësisë është e parashikuar në rregulloret e

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

98 / 108

përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	brendshme, <i>nuk ka praktika që të evidentojnë me raste konkrete pjesëmarrjen e aktorëve të jashtëm me përjashtim të GVJ që janë pjesë e akreditimit institucional dhe të programit të studimit.</i> Evidenca 1 Statuti i UGJ Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në aktet e brendshme rregullatore të UGJ janë të përcaktuara qartë njësitë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përbërja e tyre si dhe detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse. Në këtë funksion janë hartuar edhe rregulloret e brendshme për secilën prej këtyre njësive: – Njësinë bazë / kryesore – Sekretarinë mësimore – NJSBC / SSKC Evid. III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC Evid. VI.8.1 Vendim Senati për miratimin e NJSBC në UGJ
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	DMIF (në bashkëpunim me NJSBC dhe SSKC) është njësi kryesore përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së programit të studimit bachelor në “Teknologji Informacioni”. Në këtë funksion kjo njësi propozon anëtarët e grupeve të punës për çështje specifike si dhe për GVB për akreditimin e këtij programi studimi. Në këto grupe pune ka përfaqësues si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët e këtij programi studimi. Gjithashtu personeli akademik i DMIF dhe FSHN, sekretaria mësimore, biblioteka (personeli administrativ) si dhe studentët janë aktorët kryesor përgjegjës për mbarrëvajtjen e aktiviteteve ditore për këtë program studimi. Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC Evid. II.27 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AMzF Evid. II.27.1 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AGJl Evid. IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin Evid. V.6 Raport statistikor student-pedagog për çdo fakultet Evid. VI.6.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të	Respektimi i integritetit akademik dhe shmangia e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve

brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	gjatë proceseve të vlerësimit apo kohëzgjatjes së punës / studimeve parashikohet dhe sigurohet nga Kodi i Etikës i UGJ si dhe nga zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC Evid. III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës Evid. IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.PDF Evid. VI.6 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga evidencat e prezantuara nga GVB, pjesëmarrja e aktorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë është e kufizuar në pjesëmarrjen e profesorëve të huaj në dhënien e titujve në UGJ. Pavarësisht se rregulloret e brendshme e parashikojnë përfshirjen e aktorëve të jashtëm në procesin e SBC, përfshirja e tyre nuk është një praktikë e ndjekur në mënyrë të rregullt. <u>Sugjerohet që në SBC për këtë program studimi të përfshihen edhe aktorë të jashtëm si ekspertë të SC ose përfaqësues të sektorit të biznesit.</u> Evid. III.15.5 Liste e profesoratis të huaj të angazhuar në dhënien e titujve në UGJ Evidenca VI.8 Rregullore e NJSBC			
Konkluzione	UGJ përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Megjithatë në proceset e SBC-së sugjerohet që të ketë një përfshirje më të gjerë të aktorëve të jashtëm si ekspertë të SC, përfaqësues të biznesit etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

100 / 108

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Struktura e NJSBC, rregullorja e kësaj njësie si dhe programi transparencës së UGJ janë të publikuara në faqen elektronike zyrtare të UGJ. Informacione specifike që nuk janë publike në lidhje me SBC për programin e studimit mund ti mundësohen të interesuarve me kërkesë të tyre sipas politikave dhe procedurave të UGJ. Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC Evid. VI.8.1 Vendim Senati për miratimin e NJSBC në UGJ https://uogj.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-koordinatori-institucional/ https://uogj.edu.al/transparenca/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit bachelor në “Teknologji Informacioni” publikohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ndërkohë në faqen elektronike zyrtare të UGJ janë publikuar RVB për programet e studimit në proces akreditimi. https://uogj.edu.al/old/akreditimi-i-programeve-te-studimit/ Evid. IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga raportet periodike të njësisë bazë apo dhe NJSBC shpesh identifikohen mangësi dhe problematika si dhe jepen sugjerime për përmirësimin e tyre. Megjithatë në këto raporte <u><i>mungon hartimi i një plani masash për mënyrën dhe afatet kohore e adresimit të këtyre mangësive.</i></u> Evid. I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025 Evid. I.3.2 Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UGJ-së Evid. I.3.3 Strategjia e kërkimit shkencor në UGJ Evid. I.6 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës Evid. I.8 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sipas RVB dhe rregulloreve të brendshme të UGJ, NJSBC dhe SSCK vlerësojnë dhe sigurojnë efektivitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore në kuadër të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Megjithatë shpesh herë raportet e këtyre njësive përfundojnë në gjetje dhe rekomandime por jo në plan konkret masash për përmirësimin e situatës. Një tjetër mënyrë për përmirësimin e programit të studimit është zbatimi i rekomandimeve që vijnë nga procesi i

	akreditimit institucional dhe i akreditimit të programit të studimit. Evid. I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Pjesëmarrja në panairët e punës për promovimin e programit të studimit bachelor në "Teknologji Informacioni" të maturantët është një nga aktivitetet periodike për sigurimin afatgjatë të vazhdimësisë së programit të studimit. Nga ana e DMIF / UGJ janë zhvilluar pyetësorë për personelin dhe studentët por këto aktivitete shpesh janë për situata të caktuara dhe nuk kanë një përsëritje të rregullt periodike. Evid. I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë Evid. VI.8 Rregullore e NJSBC			
Konkluzione	<i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i> <i>Sugjerohet që në kuadër të aktiviteteve për SBC:</i> - Të krijohen aktivitete të rregullta periodike (trajnim i personelit akademik, anketime për studentët etj.) për një standardizim të procesit të SBC. - Hartimi i një plani masash me aktivitete dhe periudha kohore të mirëpërcaktuara për gjetjet e raporteve të njëjësive monitoruese të SBC.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Eqrem Cabej”, Gjirokastrë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Zhvillimi i plotë i disa prej lëndëve karakterizuese në auditorë të pajisur me pajisje informatike, të nevojshme për përcimin e njohurive.
2. Institucioni paraqet një qëndrueshmëri në vite të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
3. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është unik në rrethin e Gjirokastrës.
4. Investimet në fondin e bibliotekës.

Pika të dobta:

1. Ndarja e lëndëve të këtij programi studimi në kategori sipas VKM 41 e ndryshuar, nuk është plotësisht në përputhje me objektivat formuese të këtij programi, duke caktuar si lëndë bazë, lëndë që për tu përvetësuar kërkojnë njohuri të përçuara në lëndë të formimit karakterizues. (Standardi II.1, kriteri 3; Standardi II.3, kriteri 2; Standardi II.4, kriteri 2, 3 dhe 4)
2. Jo të gjitha lëndët e këtij programi studimi kanë të përcaktuar titullarin dhe lektorin me kualifikimet e kërkuara nga aktet rregullatore në fuqi, sidomos për personelin me profil në lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit. (Standardi II.1, kriteri 1 dhe 3; Standardi II.3, kriteri 4, Standardi IV.1, kriteri 3)
3. Mungesa e një lënde “Praktikë Profesionale” që të zhvillohet pranë bizneseve apo institucioneve bashkëpunuese për të afruar studentët me tregun e punës. (Standardi I.2, kriteri 3, Standardi II.1, kriteri 4, Standardi III.4, kriteri 1, Standardi IV.1, kriteri 8)
4. Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve, nuk kanë të ndara në kredite dhe orë në auditor aktiviteteve formuese si Leksione, Seminare/Ushtrime, Laboratore, Detyra/Projekte kursi etj. (Standardi II.3, kriteri 5; Standardi II.4, kriteri 2, 3 dhe 4; Standardi III.4, kriteri 1)
5. Institucioni nuk përdor si njësi matëse të nevojës së orëve në auditor dhe të përcimit të njohurive kreditin ECTS, duke patur lëndë të të njëjtës kategori, me numër të ndryshëm kreditesh që kanë të njëjtët orë në auditor (Standardi II.3, kriteri 5; Standardi II.4, kriteri 2, 3 dhe 4; Standardi III.4, kriteri 1).
6. Mungesa e pyetësorëve periodik për studentët për shprehjen e opinionit të tyre për cilësinë e procesit mësimor si dhe për punën e personelit të UGJ (Standardi V.5, kriteri 3, Standardi VI.1, kriteri 2 dhe 3, Standardi VI.3, kriteri 4).

7. Institucioni harton strategji dhe objektiva për përmirësimin në tërësi të shërbimeve që ofron, por nuk paraqet plan masash shoqërues për gjetjet dhe përmirësimin e tyre. (Standardi III.1, kriteri 5 dhe 6, Standardi VI.3, kriteri 2, Standardi VI.5, kriteri 3).

Rekomandime:

1. Institucioni të rishikojë shpërndarje e lëndëve në kategori sipas VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar, në përputhje me objektivat formuese të këtij programi studimi.
2. Institucioni të krijojë mundësi për kualifikimin e më tejshëm të stafit akademik, sidomos atyre në profilin karakterizues të këtij programi studimi për të garantuar së paku staf me gradën shkencore “Doktor” apo/edhe të rekrutojë personel akademik të ri në këtë profil.
3. Të shtohet lënda e “Praktikës Profesionale” në planin mësimor duke hartuar edhe syllabusin përkatës.
4. Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve të ndajnë në mënyrë të qartë kreditet e lëndës për aktivitetet didaktike formuese, si leksione, seminare/ushtrime, laboratorë dhe projekte/detyra kursi. Gjithashtu, për të njëjtën tipologji aktiviteti formues, të përcaktohet një normë e konvertimit midis krediteve dhe orëve në auditor.
5. Institucioni duhet të krijojë mekanizma/pyetësor periodik për të marrë mendimin e studentëve mbi proceset e brendshme të UGJ dhe ti bëjë ato pjesë e strategjive për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
6. Hartimi i strategjive dhe objektivave për programin e studimit, duhet të shoqërohen me mekanizmat e realizimit të tyre dhe me tregues të matshëm të realizimit të objektivave.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Information Technology" provided by the Higher Education Institution "Eqrem Cabej", Gjirokastër

Strengths and affirmations

1. Carry out all the teaching activities of some of the characteristic subjects in classrooms equipped with computer equipment.
2. The Institution has a stable number of academic staff engaged in this course of study over the years.
3. The Bachelor study program in "Information Technology" is unique in the district of Gjirokastra.
4. Investments in the library fund.

Weaknesses

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

104 / 108

1. The division of the subjects of this study program into categories according to VKM 41, as amended, is not fully in line with the educational objectives of this program, designating as basic subjects, subjects that, in order to be mastered, require knowledge from characteristic or higher subjects. (*Standard II.1, criterion 3; Standard II.3, criterion 2; Standard II.4, criterion 2, 3 and 4*)
2. Not all courses of this study program have lecturers in possession of the qualifications required by current regulations. (*Standard II.1, criterion 1 dhe 3; Standard II.3, criterion 4, Standard IV.1, criterion 3*)
3. Lack of a "Professional Practice" course to be carried out at cooperating companies or institutes to bring students closer to the job market. (*Standard I.2, criterion 3, Standard II.1, criterion 4, Standard III.4, criterion 1, Standard IV.1, criterion 8*)
4. In the study program and course syllabi there are no clear subdivisions of credits and classroom hours between academic activities such as lectures, seminars/exercises, laboratories, course tasks/projects, etc.. (*Standard II.3, criterion 5; Standard II.4, criterion 2, 3 dhe 4; Standard III.4, criterion 1*)
5. The institution does not use the ECTS credit as a unit of measurement for the need for hours in the auditorium and for the transmission of knowledge, having subjects of the same category, with different numbers of credits that have the same hours in the auditorium (*Standard II.3, criterion 5; Standard II.4, criterion 2, 3 and 4; Standard III.4, criterion 1*).
6. Lack of periodic questionnaires for students to express their opinion on the quality of the teaching process as well as on the work of the UGJ staff. (*Standard V.5, criterion 3, Standard VI.1, criterion 2 and 3, Standard VI.3, criterion 4*).
7. The institution designs strategies and objectives for the overall improvement of the services it offers, but does not present a plan of accompanying measures for their findings and improvement. (*Standard III.1, criterion 5 and 6, Standard VI.3, criterion 2, Standard VI.5, criterion 3*).

Recommendation

1. The institution should review the distribution of subjects in categories according to VKM 41, dated 24.01.2018 as amended, in accordance with the formative objectives of this study program.
2. The institution should create opportunities for the further qualification of academic staff, especially those in the characteristic profile of this study program to guarantee at least staff with PhD qualification or/even to recruit new academic staff in this profile.
3. To add the subject of "Professional Practice" to the curriculum by drafting the relevant syllabus.
4. The curriculum and course syllabi clearly allocate course credits to formative didactic activities, such as lectures, seminars/exercises, labs, and course projects/assignments.

Also, for the same typology of formative activity, a conversion rate between credits and hours in the auditorium should be determined.

5. The institution should create periodic mechanisms/questionnaires to obtain students' opinions on the internal processes of UGJ, and make them part of strategies for continuous quality improvement.
6. The design of strategies and objectives for the study program must be accompanied by the mechanisms of their realization and measurable indicators of the achievement of the objectives.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

108 / 108

